

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-32
C H1

*Bashkim
Çepele*

*Nga mesi
i fushës*


tregime

8SH-32
C 41

**Bashkim
Çepele**

**Nga mesi
i fushës**

tregime



628

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LIRIKË PRANVERE

Në sallën e madhe të barit, ku gjithçka vezullonte, zotëronte një qetësi çlodhëse. Dëgjohej vetëm vërvshëllima e rrregullt e ekspresit në banak.

Poeti Fan Dragoti piu kafen me gjellënjka të mëdha dhe pastaj u rehatua mirë e bukur në kolltukun e gjerë e të butë. Përmes xhamillëkut dhe perdeve të lehta, si përmes një mjegulle të hollë, dukej sheshi dhe një pjesë e rrugës ku shpejtonin kalimtarë e biçikleta e ku në çdo sekondë dëgjoeshin boritë e vetrurave dhe të urbanëve. Nën pishat përballë barit, në stolat prej guri, midis lehevë të mbjella me lulezjarre vraponin e qeshnin një grup vajza. Kishte ardhur pranvera me diellin e madh mbi çatitë e kuqe të këtij qyteti, me blerimin e parqeve dhe lulëzimin e gonxheve, me gërshtat e shpleksur të shelgjeve lotuese, që vareshin mbi ujin e kthjellët të lumit, me ngjyrat e çelëta të fustaneve dhe të bluzave.

Poeti Fan Dragoti ndihej i hutuar në këtë stilë dhe një dobësi, si një trishtim i ëmbël marramendës, e pushtonte të tërin.

«Kjo vjen, — mendonte, — se jeta është kaq e

bukur, kaq e vrullshme dhe e ngjyrshme!... Dhe unë nuk arrij ta pushtoj të tërën në krahët e mi, ta jetoj tërësisht atë, ta hedh në letër poezinë e saj të fuqishme, me po atë nerv që ka».

Kamerierja, e gjatë dhe përherë burzëqeshur, kaloi pranë poetit.

— Një shurup shege, ju lutem!

Buzëqeshja dukej sikur thoshte: «Gati!» Poeti hapi çantën dhe nxori që andej një bllok me kapak të fortë. E hapi dhe lexoi: «Lule shege. Poezi». Pastaj shflettoi bllokun dhe filloi ta lexonte saqe për faqe.

«A ka mundësi, vallë? — pyeste me vete. — A është e mundur të jenë poezi të një vajze me tetë klasë, për më tepër të një kooperativisteje?». — Dhe Fan Dragoti tundte kokën si me dyshim.

Kamerierja solli shurupin. Ai ndjeu aromën karakteristike të një fushe ku kanë lulëzuar shegët.

«Edhe në saqet e këtij blloku kundërmon dhe përhapet ky parfum shegësh, duken në të fushat dhe lumi, nata e butë e korrijeve dhe këngët e vjelëseve të pambukut, duket njeriu i ri. A është e mundur t'i ketë shkruar ajo vajza kooperativiste, me tetë klasë?»

«Vetëm se e përdor tepër peizazhin, — vazhdoi mendimin. — Por kjo me kohë shmanget»... Nxori stilografin dhe shkroi.

«Poezi të freskëta, militante, origjinale. Të luftohet akuareli që vihet re në disa prej tyre!»

«A thua janë vërtet krijime të saj?» — pyeti sërisht veten dhe ndoshta për të njëqindtën herë rrudhi supet me dyshim.

Poeti pagoi dhe doli nga bari.

Që kur kishte marrë atë bllok shënimesh nga një shok i tij, kryeredaktor i një gazete lokale në Jug, poeti Fan Dragoti s'bënte qetësi. Ato poezi ishin të kooperativistes Besa Driza, nga fshati E. Poeti Fan Dragoti kishte qenë përparrë njëzet vjetësh në atë fshat. Dhe poezitë e Besa Drizës ia kishin sjellë ndër mend përsëri fshatin me hollësi.

Fan Dragoti kishte parë midis vargjeve të poezeve të Besës kurorat e luleve dhe kokrrat e shëgëve varur përmes kaçubene të drurëve, kishte parë lumin, pasqyrimin e diellit mbi sipërfaqen e tij të lëmuar, madje kishte ndier dhe gurgullimën e tij, kishte ndier aromën e akacieve, të piergu llave të kacavarura pas plepave, aromën e manave të ugareve. Por Fan Dragoti kishto përrë midis atyre vargjeve një diell aë të lëburte sutë me dritën e tij, kishte parë të lëvizte përmes vargjeve jo fshatarin pa këpucë e me fytyrë të hequr, por një fshatar energjik e hapsigurt, i cili me sy të qeshur, çante përmes tokave që s'u dukej fundi.

Atëherë poeti Fan Dragoti kishte fshirë me pëllëmbën e dorës nië lot, që kishte filluar t'ia lagte aernikët. Lot gjëzimi për atë vaizë të nanjohur, që ditën punonte arën dhe mbrëmjeve shkruante varai për tokën në atë fletore ku ai kishte riitetur dhe thërrmia balte e petaleza të thara bimësh.

* * *

Pas disa ditësh, poeti Fan Dragoti mori trenin e mbrëmjes për në qytetin B. Atje mbërriti vonë. Zuri hotel, i telefonoi kryeredaktorit të gazetës lokale dhe zbriti në barin e hotelit. Orkestra luante «Fantazi për fizarmonikë» dhe atij iu duk sikur era e ngrohtë fryu e lëkundi majat e plepave dhe i gufoi si vela perdet e bardha të mermarta.

Kryeredaktori s'vonoi të vinte. Ata porositën raki dhe ia nisën në fillim një bisede për Tiranën, për poezinë, për gazeten, për plazhet. Po fjalë u rrotullua nga u rrotullua dhe doli atje tek duhej.

— Epo arti njeh dhe raste të tilla, — tha ngadalë, por shkoqur kryeredaktori, pa fshehur entuziazmin e vet.

Poeti ngriti supet në një mënyrë të papërcaktuar, ndërsa kryeredaktori vazhdoi:

— Pastaj, poezinë gojore, poemat epike të Mujit dhe të Halilit, baladën e murimit, atë të Gjerqij Elez Alisë, etj., etj., kush i krijoj? Cili qe ai dhe ç'universitet pati mbaruar?... Ai mbasë s'dinte as shkrim e as këndim!.. — vuri burzën në gaz kryeredaktori.

— Ato i ka krijuar një popull i tërë, — tha poeti, duke tundur dorën në ajër sikur të trembte një mizë të bezdisshme.

— Po përse të duket i pamundur përvetësimi në fshat i dijeve mbi botën dhe shoqërinë, histo-

rinë dhe artin?... Këtu je plotësisht i gabuar. Megjithatë, e mira e punës e do të shkosh në fshatin E. dhe të njihesh me Besa Drizën...

— Patjetër, për këtë kam ardhur. Besoj se do të shkojmë bashkë. Kështu është më mirë...

Poeti piu një gllënjkë raki. Edhe kryeredaktori piu. Pastaj tha:

— Nesër në orën nëntë më duhet të jem në Tiranë. Më vjen keq, po nuk mundem të të shqëroj.

Kryeredaktori me poetin thirrën kamerieren, paguan dhe dolën.

Poeti u nis vetë për në fshat. Si zbriti nga makina, kishte pyetur për mua dhe ma sollën drejt e në zyrë. Trokiti dera. Ai hyri. Unë, i habitur nga kjo vizitë, u ngrita më këmbë dhe të dy u përqafuam.

— Më thanë se vitin e kaluar ke thyer tri karrige duke ndenjur tërë ditën mbi to, — poeti, dikur mësuesi im i klasës së pestë, tundi gishtin si me qortim.

— Që kur kam ardhur në këtë zyrë, para tre vjetësh, kam pasur vetëm këtë karrige dhe, siç e shihni, ajo është fare e re.

Mësuesi qeshi.

— Kështu mbettë pérherë! — uroi duke i dhënë zërit një ton solemn. Urimi i tij më ngrohu.

— Dhe ti, pérherë në lëvizje qofsh! — shtoi.

Folëm. Kujtuam shokët dhe shoqet e klasës sime, nxënësit e tij.

— Janë shpërndarë, — i thashë. — Dhe në bujqësi kanë mbetur fare pak.

Ai pyeti gjerë e gjatë për punët tona, për koooperativistët, për problemet kulturore, për shqetësimet dhe interesat e të rinjve.

Jashtë, matanë rrugës qe fabrika e miellit, dhe zhurma e butë, si e përgjumur e rrotave, sitave dhe rripave të shumtë të transmisionit vinte në zyrë si e mbytur.

— Mos bie shi? — pyeti mësuesi. Po shpejt, para se unë ta kuptoja plotësisht këtë pyetje të befasishme, ai qeshi. Duket iu kujtua që, kur hyri në dhomë, qelli i madh qe pa një fjollë reje. Dolëm. Unë propozova të udhëtonim me motor, por atij ia kishte qejfi të ecnim më këmbë.

— Kam mall, — tha, — megjithëse fshati që njihja unë as nuk ekzistoka. Sa paska ndryshuar!

Ai ecte aty përpara, me hap të ngadaltë, midis lehevë me grurë, nëpër ato udhëza të drejta, të rrahura nga mijëra këmbë.

Në të majtë të rrugës, përtej kanalit të madh që shërben për të pritur ujërat e tepërtë të lumenit, kur ai del jashtë brigjeve, ishte një parce-lë disahektareshe e mbjellë me tërfil. Ajo ngjante si një det i bukur. Dy motokarro venin e vinin pa pushim, duke shtyrë përpara makinakorrëset e duke lënë përbri si të palosur tërfilin e njomë. Fshatarët pas tyre nxitonin ta ngarkonin në zetorë.

Ne kishim zënë një udhë që të nxirrte në trojet e mocaleve të dikurshme. Kudo kishte gja-

llëri. Traktorët, zetorët, motokarrot elektropom-pat, që thithnin ujin nga lumi dhe mbushnin vijat kulluese të parcelave të grurit, zhurmonin pa ndërprerje. Vende-vende një varg tubash gome, që shtriheshin tejtej parcelës, bënин vaditjen me sprucim.

— Mungesa e shirave na ka hapur avaze serioze, — i shpjegova mësuesit. — Ne kemi grurë të hershëm, që tani ka çuar kallirin. Mungesa e lagështisë në këtë periudhë mund të shkaktojë sterilitet, të ulë numrin e kokrrave për kalli... Me një fjalë rrezikohet rendimenti. Prandaj dhe i kemi vënë rëndësi kaq të madhe ujitjes dhe po i përdorim të gjitha llojet e saj, që nga mbushja me ujë e vijave kulluese e deri te vënia në përdorim e impianteve ujtëse.

Mësuesi vështronte me njëfarë malli dhe interesim të dukshëm tërë ato toka të sistemuara dhe avullin e mjegullt të pikave të vogla të ujit që e rrëmbente era. Mua më lindi mendimi se mësuesi kishte kohë pa ardhur në fshat. Kushëdi.

— S'ia dilnim dot mbanë pa ndihmën e makinës bujqësore. Ajo i hoqi barrën e rëndë nga shpina fshatarit tonë.

Ai vazhdoi të ecte në heshtje. Pastaj, në mënyrë gati proverbiale, tha:

— Edhe makina i dha mundësi Besa Drizës të merret me poezi!... — pastaj pyeti: — E njëh Besa Drizën?

Unë qesha.

— E njoh? Patjetër që e njoh! Po ju si e njihni?!

- Shkruan poezi... — tha mësuesi. Ishte diçka midis pohimit dhe pyetjes.
- E di, shumë nga ato i këndojnë vajzat në ara dhe nëpër dasma, — i thashë.
- Domethënë i shkruan vetë? — mërmëriti ai. Unë u habita.
- Po kush?
- Më fal... më fal!...

Ne ikëm më tutje. Morëm një rrugë tjetër që futej në thellësi të fushës, drejt detit. Udhë shkonte përmes fshatit.

- Si je, teto Senë? — përshëndeta.
- Mirë, shqyqyr!... Po ti si më je, o sekretar? — Teto Sena, që po shkriféronte tokën me një prashajkë, drejtoi trupin dhe vazhdoi: — Do të kemi shi, o sekretar, dhe ky shiu i tanishëm pikë e flori është, dëgjo teto Senën ti. Ma thonë eshtrat mua, që më çajnë. Dhe e kam një me një unë, o sekretar; po nisën të çajnë e të therin këto kokallat e mia, shiun e ke mbrapa derës.

Unë qesha.

Edhe mësuesi qeshi i kënaqur.

- A mos është Sena, kuzhinierja kjo? — pyeti mësuesi.

— Po ti hidhe pragun, merre mikun dhe hajdeni t'ju bëj një kafe taze. Sa e poqa dhe e kam lënë të ftohet... Hajde! — dhe pa pritur përgjigje hyri e para në shtëpi.

— Po, po. Është e ëma e Besës, — i pohova mësuesit ngadalë.

— Ashtu?... Vemi. të lutem! — u nxitua ai dhe më tërroqi për krahu për nga porta e oborrit.

— Hajde, hajde të pish kafe, o mik, dhe t'u thuash nga të shkosh, se kafe si teto Sena s'bën njeri, sikur edhe në Stamboll të vesh, — fliste Sena që, pasi hapi derën e konakut të miqve, nxitoi të pastronte duart.

Stambolli, me sa dukej, ishte kufiri më i largët i botës për teto Senën.

Hymë në shtëpinë e plakës.

— Paskan televizor?! — u habit mësuesi.

— Çoç ecim edhe ne, o mësues, — i thashë. — Teto Sena s'të njohu. Do të çuditet kur ta marrë vesh... Moj teto! — thirra.

— Javash, se erdha! — u përgjigj plaka nga kuzhina. — Javash, se më pritet kafeja, se dua t'i bëj një kafe këtij mikut, që më urdhëroi në shtëpi e që për të mira iu mbledhshim! Ja, urdhëroni dhe ju bëftë mirë! — plaka uli mbi tavolinë diskun me filxhanët e kafesë.

— Ehu, hel!.. Sa herë më ke dhënë për të ngrënë e për të pirë, moj teto, aq të mira paç!

— Ja-a! — u habit plaka. — S'më ngjan...

Teto Sena ia nguli sytë mësuesit një copë herë të gjatë. Nuk e njohu.

— U plaka, — tha. — S'mbaj mend.

— Kanë shkuar shumë kohë që atëherë, moj teto. Unë kam qenë mësues këtu dhe vija haja në mensë. Unë jam ai çuni i Tiranës, që më akuzoje se vija era vezë, meqenëse më pëlqenin t'i pija ashtu të gjalla ose t'i rrihja... Ende s'po të kujtohem? — Mësuesi qeshi.

— Fani, je ti? — pyeti me dyshim plaka.

Mësuesi pohoi me një të lëvizur të kokës. Plaka qeshi si me turp. I ranë lot dhe ajo u mun-

dua t'i fshinte me cep të shamisë. Pastaj qeshi me të madhe.

— Kush na paska ardhur!... Dhe unë kërcurja rri e llomotis!... Dhe sekretari po dëgjon e s'më thotë që në krye... — Ajo e përqafoi mësuesin në të dyja faqet si djalë. — Po ti më je bërë njeri i madh tashti, more bir. Emrin ta kam dëgjuar, po me ty s'jam parë, ohu, qëkur!... Po dhe paske ndryshuar shumë, o bir. Je trashur dhe në kokë s'i paske më ata flokë të bukur... Ç'flokë që ke pasur, pa!... Ajo mësueska, Vangjelia, ajo nga Fieri, de, e mban mend? Ajo më thoshte se, sikur një lek të mos bëje, vetëm për ata flokë ia vidente të fejohej me ty. E varfra! Dha e dha, por s'doli gjë. Ti gur se gur! Qerrata! — dhe plaka i shkeli syrin me aq çapkënllek, sa mësuesi dhe unë nisëm të qeshnim.

— Por, ama, era vezë e gjallë vije, vërtet, që atje tutje! — dhe përsëri qeshi me gojën pa dhëmbë. — Po nënën e ke më, o Fan?... E shkreta! Po plaku, të rron apo ka vdekur, edhe ai?... I ziu!... Nejse, të rrosh vetë e të të rrojnë fëmija! Sa ke?... Ja-a! Turp dhe gjynah!... Me një fëmijë?! Ne bëmë nga dhjetë e s'ngopeshim. Mos kemi qenë budallenj? S'ngopeshim, po, se njeriu, me jetën një e me evlatët dy, s'ngopet kurrë... Paçka se je i ditur, edhe ne dimë...

— Teto, mësuesi ka dëgjuar për Besën dhe ka ardhur të njihet. I ka lexuar vjershat e saj.

Plaka heshti gjatë. Tani në sytë e saj shquhej një hall dhe një merak i madh. Rrinte në heshtje dhe vështronte herë mësuesin e herë mua dhe tundte kokën me leshra të thinjura.

— Si të të themi, or t'u bëftë tetua! E mbasë s'bëjnë pér të. Po edhe më dhimbsét. Shoqet e saj lozin e qeshin, ajo rri e lexon libra e gazeta. Ne biem të flemë, ajo rri e shkruan, tërë natën e natës... Ja, kështu, Besa... I them ndonjëherë «Shiko shatin e draprin, atë bëj dhe mbaji fort, se ata na kanë mbajtur ne, tët gjysh, tët atë e gjithë soj e sorollopin tënd! Atë bëj ti... i them, se pér këngë e pëi libra s'ka dalë ndonjë mashkull nga kjo derë e jo të dalë një çupërlinë...» Po, o Fan, s'ma ka vënë veshin e as ma vë, — qeshi plaka e menduar pér ato që tregoi.

Mësuesi e dëgjonte me vëmendje, pa ia ndërprerë fjalën e, duke tundur kokën, pohonte në heshtje:

— Mësueskë Alma thotë se i bën të bukura këngët ajo çupa ime, ore Fan, t'u bëftë nëna ty!... Kështu thotë ajo... Ku di unë qysh të them!

— E ka drejt mësuesja, teto Sena, — e siguroi mësuesi.

— E, e, ashtu vërtet. Po ja, mësues Loli thotë se nuk bëjnë asnë para dhe shpesh më thotë se çupa më kot i prish sytë. Mësues Loli ka mbaruar shkollë të madhe në Tiranë, ore bir. Çoç di ai, pa thotë ashtu, se inat dhe hasët nuk e ka, de! Ai e ka kërkuar pér grua, dhe jo një herë e dy, po s't'i numëroj dot, or bir!... Edhe vëtë e ka kapur mësues Loli e i ka thënë një mijë broçkulla që, edhe mua, plakë e rrëgjuar, ma prishin mendjen dhe ma bëjnë erë. Edhe mua më është lutur, dhe njerëz ka vënë që t'i bëhen krah e t'ia mbushin mendjen asaj. Po pse, do t'ia dijë ajo, thua?!... — Plaka mblodhi supet dhe s'foli më.

Kur dolëm, mësuesi i tha teto Senës:

— Do të shihemi përsëri, nënë. Po ti duhet të kesh më shumë besim në forcat dhe në punën e vajzës sate... Pa le të flasin si t'ua dojë oreksi mësues Loli e ndonjë tjeter si ai...

Mësuesi ecte me hap të ngadaltë, midis lehevë me grurë, nëpër atë udhëz të drejtë, të rrahur nga mijëra këmbë. Që atëherë kanë rrjetur shumë vite. Ai tani i ka kapërcyer të dyzetat, është trashur dhe në kokë i ka mbetur vetëm një kurorëz e valëzuar nga flokët e tij të bukur kaçurrrelë.

Edhe unë tani jam tamam burrë. Megjithatë, tek e shoh të vërtitet arave, rrugëve dhe rrugicave të fshatit, tek ulet dhe harrohet buzë lumi, apo në pyllin me plepa, më shfaqet para sysh ajo kohë kur isha njëmbëdhjetëvjeçar.

...Në duar mbaja një sahan me petulla dhe nxitoja në rrugën gjithë pluhur për te mësuesi. Ishte e diel dhe nëna, që e dinte se ai nuk kishte ku të hante darkë, sepse mensa të dielave mbyllej, përgatiti ca petulla. Shtrëngojë në duar sahanin dhe qëndrova para derës së mbyllur të dhomës së mësuesit. Brenda dëgjoheshin zëra dhe pastaj u dëgjua një e qeshur e hovshme.

— Mësues, mos i lër qepët mbi oxhak, se t'i ha miu! — dëgjoi zërin e Shyqos.

— Vërtet?!... Pse, ka minj këtu?... Hiqi, të lutem, vëri në dollap! — shqetësohet mësuesi. Ai nuk e di që miu s'para i ha qepët. Shyqoja qesh me të madhe, i kënaqur nga ky «zbulim» dhe thotë me entuziazëm:

— Po miu nuk ha qepë...

Përsëri qeshin me të madhe. Qesh edhe unë prapa derës: hi-hi-hi... Dhe sahani me petulla lë-kundet poshtë-lart së bashku me trupin tim të hollë. Hapet dera me vrull. Unë mbetem i ngrirë dhe s'di c'të bëj.

— Mirë se erdhe! — më thotë një shok imi, Andrea, që ma merr sahanin e e vë mbi oxhak. — Ta pacim hua! Në dasmë të sat ëme!...

Përsëri të qeshura. Qesh edhe unë. Qeshim gjatë. Hi-hi-hi- ha-ha-ha!... Pastaj vështrimi ynë mbeti te mësuesi. Fytyra e tij qe bërë serioze dhe pa kuptuar edhe ne marrim pamjen e tij.

— Kush përdor shprehje të tillë nuk është miku im! — thotë mësuesi me një ton të ngadalëtë dhe të prerë.

Ne heshtëm. Andrea u skuq deri te veshët. Pastaj tha:

— Më falni. shoku mësues!... Për shaka e thashë.

Përsëri aeshëm. Qeshi edhe mësuesi. Pastaj hënërëm netullat. Shyoja kishte sjellë peshk të piekur në tiegull. Andrea kumbulla, Miti qepë të njoma dhe djathë...

— Sonte jam ushqyer si princat në përralla, — qeshi mësuesi.

Pastaj mori nga rafti një libër me vjersha dhe nisi të na lexonte. Ne heshtnim. Kështu ndodhë gjithmonë.

Vjershat e bukura që na lexonte mësuesi, zërat e natës. vakësinë e ajrit të pranverës së parfumuar me aromën e pyllit dhe të fushave, të qe-

shurat plot kumbim të shokëve, kënga e bilbilit atje mbi degët e gjelbra të dardhës, këto kujtoj sa herë dëgjoj të flitet për mësuesin tim. Ja, edhe tani, ajo atmosferë e ngrohtë poetike më ka push-tuar të tèrin.

— Këtu kanë qenë lëndinat e barit, — foli më-suesi dhe tregoi me dorë një arë të madhe ku sapo kishte filluar të verdhej gruri.

— Ohu!... Shumë vite më parë, — thashë unë.

— Kurse këtu kanë qenë lerat e buacave, — më pyeti ai, — apo gaboj?

— Jö, nuk gaboni!

Vazhduam të ecnim ngadalë. Më shumë hesht-nim, shikonim fushën dhe arat. Në të vërtetë unë shikoja atë, mësuesin tim, si vështronë përreth me kujdes, si buzëqeshte.

Lëvizim ngadalë dhe vështrojmë peizazhin. Karroca, makina, zetorë dhe qerre venë e vijnë rreza e diellit, të vrasin sytë me bardhësinë e mureve, që vetëtijnë midis gjelbërimit të arave dhe të pemëve. Nëpër kopshte kanë lulëzuar shegët. Sa shumë shegë!... Lulet e tyre skuqin si flakëza mes oborreve, ndanë arave me grurë, në argjinaturën e lumit. Ajri të deh me kundërmimin e èmbël të fletëve të hardhive.

Toka e mbuluar me gjelbërim dhe lule, qelli i lartë i larë më drithë, plepat kanadezë që frushfu-llojnë dhe rrëzojnë pushin e sytheve të tyre si pam-buk i shkrifët, gazmohen e ngazëllohen nga kori i mijëra zogjve të fshehur nëpër gjethë.

— Po, këto duken edhe atje... — pëshpërit me

vete mësuesi. — Unë nuk e di për se është fjala. Ku duken këto? Ku ndihen këto? Ç'janë këto?...

Kështu belbëzonte edhe atëherë, afro njëzet vjet më parë. Atë natë, në fshatin tonë kishte ardhur autokinemaja. Atë darkë ne i futëm lopët ende të pangopura në kaçolle, i lidhëm pa u dhënë ujë dhe vrapiam te zyrat e kooperativës. Vërtiteshim rrëth autokinemasë, preknim me dorë aparatet me një ndjenjë dashurie përzier me druajtje dhe zili. Shikonim kasetat ku rrinte filmi, preknim pëlhirën e bardhë, të ashpër të ekranit dhe bisetonim mes nesh.

— Y-y-y-y! — skandalizohej Lili. — Të gënijer që bën! E ku e nxë kjo kuti xhaxhi Stalinin, more!... E di ti sa i madh është ai?!

— E di, e di, më mirë nga ti e di. Po ja, të shohim si të erret, kur të dalë pastaj dhe të sulet mbi gjermanët që, aman. moj nëne, aman!... Të shikosh ti kur të ngrenë flamurin e kuq në Belinë!

— Në Berlin, ore pufte! — e ndreq Ilia.

Sa më shumë errej, aq më shumë shtohej numri i njerëzve që grumbulloheshin. Ata uteshin këmbëkryq përballë ekranit, përbri aparaturave, bille edhe prapa ekranit. Operatori provonte aparatin. Herë-herë një lumë drite buronte nga syri i tij i xhamtë, çante errësirën dhe formonte nië katror të bardhë në pëlhirën e ekranit, ku në çast dilnin hijet e duarve, të kokave dhe të kapelave të kooperativistëve. Gratë punonin triko edhe pse që errësuar dhe i tregonin njëra-tjetrës të rejat e ditës. Kacatori, hipur mbi një kërcu, jepte me zë të lartë ndonjë urdhër të këshillit.

— Dëgjuat, urdhë! Urdhë! — kësilllit. Mos të

kemi llafe pastajza, — përfundonte ai. Ca burra ishin mbledhur kokë më kokë dhe këndonin:

*Djalë, kush e çlroi Shqipérinë?
Enver Hoxha me Partinë...*

Gjyshja ime tirrte me drugë dhe bisedonte me gratë e moshës. Pastaj, në mes të muhabetit, thërriste dhe, pa dëgjuar fare në isha përgjigjur, më porosiste të mos zihesha me shokët.

Ne shikonim gjithnjë nga udha. Po mësuesi nuk po dukej.

— Shkojmë ta thërrësim, — tha Andrea.

Mësuesi rrinte në errësirë, anës lumit. Ne e njohëm nga larg atë siluetë të dashur dhe iu afroam me zhurmë.

— Pushoni! — urdhëroi ai. Ne heshtëm. Vu-më veshin. Kuaknin bretkosat në lumë, midis gjethive të shtogut një bilbil këndonte me shumë zell dhe po me atë zell, pa e përsëritur kurrë melodinë e vet, i përgjigjej nga degët e manit një bilbil i dytë, e një i tretë pak më larg. Qindra e mijëra xixëllonja lëviznin nëpër errësirë, duke bërë dritë me fenerët e tyre të vegjël.

Mësuesi dukej sikur dikë priste që t'i fliste nga errësira, që andej, matanë lumit. Por ai zë nuk po dëgjohej. Mësuesi herë-herë diç thoshte. që ne nuk e kuptonim.

— C'ka ky kështu? — pyeti ngadalë Shyqoja.
— Se mos fillon filmi?!

— Ikim ne, — tha Andrea. — Kushedi...

— Eee, — ia priti Ilia, i pakënaqur nga fjalët e Andreas. — Ai dëgjon bilbilat... Poetët e pëlqejnë

shumë këngën e bilbilit. E kam lexuar në një libër.

— Ama kështu qenka, a? — tha Shyqoja dhe, pa e bërë të gjatë e pa u menduar fare, u ul ndanë udhës, mori një plis të thatë e të fortë, si gur zalli dhe ia hodhi me forcë shtogut. U dëgjua goditja midis gjetheve të dendura e të mëdha. Në çast u ndërpren edhe kënga e bilbilit.

Mësuesi u zemërua me ne atë natë dhe nuk erdhi në, kinema.

— Hajde, pulisht i varfër, hajde! — e shamë Shyqon.

— Hë, more, mos më çani kokën! — u nxeh ai. — Sikur s'ka dëgjuar ndonjëherë këngë zogu... Unë për të mirën e tij e bëra.

Pas ndonjë muaji ne lexuam në gazetë një vjershë përfshatin tonë, përf kositësit, përf ne, përf xixëllonjat, bilbilat dhe përf autokinemanë. Sa shumë na pëlqeu! Si nuk e paskëshim parë sa i bukur ishte fshati ynë!...

Vazhdonim të shëtitnim përmes arave.

— Gruri mendoj se është i mirë këtë vit.

— Po, i mirë është, — thashë. — Vitin e kaluar, në këto parcela kemi marrë katërfishin, e rendimentit që jepnin këto në kohën kur ishit mësues këtu.

— Ju lumtë! — tha ai.

— Dhe këtë vit rendimenti do të jetë akoma më i lartë, — thashë unë, jo pa krenari.

Në vatrën e kulturës në mbrëmje kishin organizuar një pasdite vallëzimi. Që këtu, një kilometër larg saj dëgjohej tingulli i mprehtë e kryeneç i klarinetës së Halitit. Ne, të lodhur e të heshetur, po kthehetëshim në qendër të kooperativës. Die-

lli kishte perënduar me kohë dhe në qielj një hënë e plotë po ngjitej ngadalë, duke derdhur pa kursim dritën e saj mbi fushë.

- Mirëmbrëma!
- Mirëmbrëma!
- Si u ngrysët?...

Kooperativistë dhe kooperativiste kthehen nga arat. Të rindërtuar, të rindërtuar, në çifte apo grupe, ecnin rrugëve, qeshnin, nxitonin për në vatrën e kulturës.

- Natën e mirë!...
- A do të vish nesër?
- E ku prashitet gruri, mor vëlla? Shati i prish rrënjen bimës.

Ne ecnim përmes tyre dhe dëgjonim dialogë të shkëputur, të përgjysmuar. Mbi majat e plepave, lart, Kashta e Kumtrit e yjet dukeshin si një lëm i madh me grurë.

— Më duket sikur eci nëpër një park të lulëzuar, ku gjithçka flet me gjuhën e poezisë... Sa bukur! — foli ngadalë mësuesi, duke marrë frymë thellë, me téré gjerësinë e gjoksit.

Pranë nesh një makinë frenoi me ulërimë. Një re pluhuri të bardhë u ngrit. Nga karroceria zbritën kooperativistë të veshur me kostumet popullore të zonës. Midis tyre qe dhe një plak. Ata u afroan me zhurmë e me të qeshura. Mësuesi, plakun e njohu menjëherë, ndërsa të rindjtë s'i njihte. Ia prezantova unë. Ata kthehen nga festivali folklorik i rrëthit.

- Si dolët?
- Mirë, — tha plaku Uan.

— Duartrokitjet qenë tē shumta, — shtoi Seiti, më i riu i grupit.

— Sidomos kënga «Do marr sharrën, do sharrët selvinë» u pëlqeu shumë, — qeshi mësuesse Alma, duke e berë Seitin, këngëtarin, tē skuqe gjer te veshët.

— Edhe vallet u pëlqyen shumë, — shtoi një ijetër.

— Ç'e do, — plakut Uan në fytyrë iu shumëfishtuan rrudhat, — s'na erdhi Qazimi. I kishte bagëtitë larg e s'e lajmëruam dot. Fyelli i tij sikur flet.

Përreth bëhej zhurmë. Dëgjohet zëri i plakut, e qeshura e Almës flokëverdhë.

Plaku Uan e vështronë mësuesin me ngulm.

— Mbaje mend, — i tha pas pak mësuesit. — Rini me dëllgë kjo e sotmja. S'të lë në baltë... Edhe e punës, por edhe e këngës!... Kënga është si buri-mi, rrjedh vetë. Edhe nxirret, por i duhet gjetur damari që tē rrjedhë. A këndëgjuar për Besën? I qan fjalët e këngëve ajo. Sikur rrjedhin ato fjalë.

— Po, po, kam dëgjuar, — pohoi mësuesi me vendosmëri. Plaku vazhdoi:

— Ka qenë te ne një shkrimtar, një i hollë me syze. Rrinte e shikonte. Mezi e nxirrte llafin, sikur i kish ngrënë gomari bukën. S'para na e mbushte synë. Por kishte shkruar goxha libër, sikur tē kishte tërë jetën në fshatin tonë e sikur tē kishim ngrënë një thes kripë... Më tregonte çupa e vogël... Këndon shumë libra ajo. Ka mbushur një sepete me majë me libra lloje-lloje, tē trashë, tē hollë... — tregonte plaku Uan. Mësuesi qeshte.

— Xhaxha Uan, hajde, se do tē tē shajë nusja,
— e nganë vajzat.

— Po të hëngri malli pér mua, më gjen kur të duash. Vër veshin e dëgjo: ku këndoijnë, atje më ke, me rininë. Rini ne, — qeshi plaku duke tokur dorën me mësuesin. Të gjithë qeshën. Pastaj u larguan.

Ne vazhduam rrugën.

Tani dëgjohej mirë violina, fizarmonika, si edhe akordet e kitarës. U afroam te salsa e mble-ihjeve, ku po vallëzohej. Nga dera dhe nga dritat dukeшин çiftet që rrrotulloheshin dhe përkundeshin nën dritat e buta të llambave. Nën atë dritë, ca më tutje, tri carroca me shtizat çift drejtuar iellit ngjanin si tyta kundërajrorësh.

— Ja tek éshtë Besa. Ajo vajza e gjatë, veshur me të kuqe e me flokë të zinj. E patë?

— Po, po, i ngjaka s'ëmës, — m'u përgjigj mësuesi.

Bëra të futesha brenda, kur ndjeva dorën e mësuesit që më ndaloi.

— Mendoj të mos hyjmë, — propozoi ai. — Le të argëtohen se e kanë me hak. Me Besën takohem nesër.

Unë vazhdova të shikoja përmes derës së hapur. Për një çast u duk fytyra e Besës, flokët e dendur e të zinj të saj, që humbi përsëri midis vallëzuesve të tjerë. Mësuesi më futi krahun dhe ne vazhduam rrugën. Përtej zyrave, në jug, gurgullonte lumi.

— Shkojmë atje? — e pyeta mësuesin. — Atje kemi ndërtuar një park. Të vogël, vërtet, por të qetë e të bukur.

— Shkojmë...

U ulëm nën akacien e bregut më të lartë. Lumi, nën dritën e hënës, dukej si një përzierje

kallaji dhe argjendi. Dëgjohej rrjedhja e ujit midis kallamave të egër dhe shelgjeve, ndihej plaquritja e peshqve që, si kërcenin mbi sipërfaqe, binin sërisht me zhurmë, duke krijuar ato gjysmë-rrethe të ndritshme.

Mësuesi vështronte përpara.

Përtej lumi dëgjohej uturima e pandërprerë e traktorëve që diskonin me nxitim tokat.

— Në këto toka do të mbjellim pambukun me kubikë. Vetëm në këtë sektor punon një brigadë e tërë traktorësh. Ama dhe njerëzit punojnë, punojnë pa kursim. Dhe toka na e ka shpërblyer mundin tonë...

Mësuesi heshtte sikur diç shihte e diç deshi-fronte në atë kompleks zérash, tinguish e drithash që buronin nga gjiri i asaj nate të ngrohtë. Papritur, atje te buza e ujit shpërtheu një e qeshur e hovshme, që mbuloi gjithë zërat e tjerë të natës.

Pranë nesh kaloi një çift që, duke çuçuritur të lumtur, nuk na vunë re.

— S'do të kisha mundur kurrë të përfytyroja në këtë fshat një mbrëmje të tillë, kaq të ngrohtë, kaq të thjeshtë dhe poetike njëherësh! — Mësuesi fliste i ekzaltuar.

— Jeta ecën dhe bën të sajën, po edhe ne ecim me të, — i thashë.

Ai pohoi me një të lëvizur të kokës.

Tani frynte një puhizë e lehtë, që bënte të dridheshin fletët e drurëve.

— Tani e kuptoj mirë ç'e ka frymëzuar Besën, — tha mësuesi. Toni i të folurit të tij të linte të kuptoje se, më shumë se mua, këto ai ia tregonte

vetes. — Jeta, ashtu si e jeton ajo, si e përfytyron ajo të bëhet... Hapësira, prania e fushës, e njeriut, e frymës së shëndetshme dhe e bukës së mirë, këto ndihen të gjitha në poezinë e saj, ashtu si ndihen në këtë natë, këtu... Poezitë e saj nuk janë pjellë e fantazisë dhe pasionit, por janë plot jetë, janë vetë realiteti. — Ai tundi përsëri një copë herë të gjatë kokën e tij të rëndë. — Duhej të vija këtu, qoftë edhe një natë të vetme, që ta kuptoja mirë këtë... Bukur!

Cifti, atje poshtë, nisi të këndonte. Zérat e tyre të pastërvitur ishin një tjeter bukuri e kësaj nate. Dashuria, që shpërthente në zemrat dhe gjakun e tyre, u jepte zérave një ëmbëlsi të veçantë, që zhdukte gabimet tekニー, pasigurinë e aritminë vokale.

«Fyelli nga mali binte...», thoshte kënga. Dhe shtrihej në natë, mbi brigjet e lumit, mbi sipërfaqjen e pruar dhe të lëmuar të tij, mbi fushën e madhe, ku përkundej kalliri i njomë i grurit e kundërmonin orkidet dhe lulet e shumta të shëgëve, mbi tokën që priste farën e re të mbjelljeve, mbi çatitë e qeta të shtëpive; frynte si një fllad i vakët që përkëdhelte gonxhet dhe i bën ato të gufojnë nga forcat e brendshme, të çelin dhe të lidhin lule dhe farë.

— Bukur!... Bukur!... Të gjitha këto duken, ndihen, lëvizin si rrryma të ngrohta në poezitë e saj... Bukur!...

— Lëviz... — thashë.

Ai pohoi dhe diç murmuriti nëpër dhëmbë. Ndoshëta fillimin e ndonjë poeme të re përfshatin që kishte njëzet vjet pa e parë...

N Ë N A

Ajo erdhi në mbrëmje vonë. Hija e trupit të saj të madh sikur e mbushi tërë oborrin nën pjerrgullën e njomë dhe njerëzit kthyen kokën të vështronin andej. Ndoshta hija u duk aq e madhe ngaqë gruaja kishte qëndruar më këmbë, para llambës treqindqirinjshe, instaluar përkohësisht për atë natë. Njerëzit e vështruani me kërshëri dhe admirim të heshtur. Kishte një fytyrë të rregullt, të gjerë, me lëkurë të rreshkur bojë gruri, rrahur nga tallazet e një jete të gjatë. Mbi ballë, nën shallin e hollë prej mëndafshi, që i kishte rrëshqitur paksa, zbardhëllonte mugët kurorë si e argjendtë e flokëve. Dhe ajo kurorë bënte që gruaja të dukej edhe më e vjetër, edhe më fisnike. Mollëzat e fajqeve i kishte të dala dhe eshtore e, ndoshta për këtë shkak sytë e saj të mëdhenj, të rrumbullakët e të menduar dukeshin edhe më të thellë nga çmund të qenë. Ishte rreth të gjashtëdhjetave.

Për dore mbante një djale që vështronte buzagaz dasmorët. Ishte nipi i burrit të saj.

Të porsaardhurit në fillim nuk i njoihu askush.

Megjithatë ata i pritën siç duhet dhe i çuan në odën e miqve.

Lazi hyri në dhomë menjëherë pas tyre. I vajti gruas në krah dhe i hodhi dorën në shpatull.

— Mirë se erdhe, nënë! — e përshëndeti ai.

Gruaja u kthyte vrulltas. Vështroi një copë herë Lazin në fytyrë dhe në sytë e saj të thellë e të menduar vezulloi një dritë e butë, e dridhshme. Pastaj ngriti me shkathtësi krahët, pushtoi kokën e Lazit midis pëllëmbëve të gjera, e shtrëngoi fort me gishtat e saj eshtakë, sikur të shtrëngonte midis tyre një duf e një mall të vjetër, të brendshëm, e buza iu drodh.

— Thashë se e harrove nënën, — tha ajo me një fije zëri. Pastaj e puthi në ballë. — Të më trashëgohesh o kurban nëna ty!...

Lazi e përqafoi dhe mbeti ashtu, midis shtrëngimit të krahëve të saj, me ballin mbështetur mbi supin e plakës.

Pastaj e mori prej krahu, e uli mbi divan e ndenji dhe vetë pranë saj. Atëherë u futën në dhomë të zotët e shtëpisë, nëna, babai, vëllezërit dhe motra e Lazit dhe e mirëseardhën gruan.

Jashtë ushtonte muzika dhe njerëzit këndonin. Nëpër korridor nuset nxitonin me tabaka e tenxhere në duar.

Gruaja e ulur në minder i kishte ngulur sytë mbi Lazin. Duart vazhdonte t'ia mbante në prehër.

— U lodhe? — e pyeti Lazi.

— Kam udhëtar gjithë ditën, — tha ajo, — dhe erdha.

— Të falem nderit, — tha Lazi.

Gruas përsëri iu drodh buza, si në vaj.

— Kisha kaq vite pa të parë! Thosha se më harrove... Por jo, thoshte im kunat, nuk të harron, hiqe atë mendje... Të kegen nëna! ...Thosha se do të ishe martuar me kohë e mua s'më kishe thënë gjë. Kur mora lajmin, u gëzova aq, sikur... — Ajo mori frysëmë thellë... — Shpirti i nënës! — dhe përsëri e përsëri ia merrte duart e ia puthte.

Lazi psherëtiu. Me këtë grua i kishte lidhur një dhimbje: vdekja e shokut të tij dhe e djalit të saj.

...Ja, kështu kishte qenë edhe ai, bojalli, si kjo, me sy të mëdhenj e të butë, tamam si eëma... Lazi psherëtiu. Ata të dy i bashkonte e njëjtë humbje, e njëjtë dhimbje: asaj i kishte ikur djali i vetëm, atij shoku më i mirë, Flamuri...

Lazi i zgjati gruas cigare. Ndezi edhe vetë një.

— Më parë s'e ndizje, më ngjan, — tha ajo.

Lazi s'foli, po rrudhi supet.

Ajo thithi cigaren thellë.

Edhe Lazi thithte cigaretën si i përhumbur. Tymi vërtitej si mjegull një cëpë herë përmbi kokat e tyre, pastaj rrëshqiste fjollë-fjollë nga kanatet e hapura të dritares dhe humbiste jashtë, atje ku gjëmonte muzika dhe kënga e njerëzve në tendën e hardhive.

— Ooooi!... — rënkoj gruaja duke i mbledhur këmbët nën vete.

Lazi mendoi se ajo duhej të ishte lodhur shumë dhe e vështroi me dhimsuri. Ai përfytyroi rrugën e gjatë deri në fshatin e saj. Ajo ishte një rrugë shumë e vështirë, që hynte thellë mes maleve. një rrugë me shumë të përpjeta dhe shumë rrëpira buzë honeve. Kishte shkuar një herë në

atë udhë, atëherë... me arkivolin e shokut mbi sup...
Sa i vështirë kishte qenë ai udhëtim!...

— O Lazi!... Hej, gëzuar!

Thërritnin shokët nga përjashta, nga tenda nën hardhitë e njoma, thërriste klarineta e shkrihej harmonika.

Gruaja e vështroi me një përgjërim prekës në thellësitë plot mendim të syve.

— Dil, — tha ajo, — të thërresin shokët.

— Jo, — tha Lazi, — do të dalim së bashku.

— Dil, — tha ajo përsëri. — Unë nuk mund...

— Mirë, — tha ai, — do të rrimë këtu brenda së bashku.

— Dil! Dil, mos ma prish qejfin, pa... do vijë edhe nëna...

Ai doli. Gruaja e ndoqi me sy derisa kapërceu korridorin e zbriti shkallët. Pastaj koka e sai me leshra të thinjura u rrrotullua nga e majta, u ngrit pak më lart dhe vështrimi iu gozhdua mbi një portret të madh varur në mur. Ishte i biri, veshur me uniformë ushtari.

— Trimi i nënës. — murmuriti plaka. — Ja, erdha në këmbën tënde!

Pastaj u ngrit, rregulloi shallin që i kishte rrëshaitur mbi supe, mbathi këpucët e doli.

...Të nesërmen në mesditë, kur nusia hyri në oborr, nëna u vërlot. Shikonte Lazin nërkrah nuses që i shëmbellente nië aershize svërkatur nga vesa e mëngjesit dhe ndjeu lotët t'i vishnin sytë, po s'e dha veten e vuri buzën në gaz. Pikërisht buzëqeshja e saj e mallëngjieu Lazzin. Shoku i tij i shtrenjtë nuk e arriti ditën e dasmës. Dhe ai kishte dashur një vajzë, Lavdushen... mësuesen e

fshatit tē tij! Lavdushen, që i shkruante letra me aq mall dhe, që e priste tē kthehej me padurim!...

Lazi e përfytyroi ashtu si e pa atë ditë, ulur më gjunjë, përkrah nënës së Flamurit, tē bukur, tē pikëlluar. Lotët i rrëshqitnin përmes faqeve tē zbehta dhe pikonin mbi bezen e kuqe tē arkivolit. Nëna, këmbëkryq te koka e arkivolit, përkëdhelte me njérën dorë bezen e kuqe tē tij e me tjetrën flokët e Lavdushes. Vetëm duart e mëdha, tē rreshkura e tërë nyje lëviznin e lëviznin pa pu-shim mbi bezen e kuqe e mbi flokët e vajzës. Ve-tëm duart. Gjithçka dukej pa jetë, e ngurtësuar, e shkretë në trupin e asaj plake, me përjashtim tē duarve. Sytë e saj tē thellë me rrathë tē zini digjeshin si nga një flakë e ftohtë. Po lot nuk kishte.

Lazi ë afruar.

— Nënë!... — kishte thënë ai, i pazoti për tē nxierrë tjetër fjalë dhe kishte rënë më gjunjë para saj.

— Ne shkonim si vëllezër, — kishte pëshpëritur Lazi.

Ajo e kishte shtrënguar më fort pas gjoksit.

— Të më rroni ju! — kishte thënë nëna përmes një gullcimi tē dhimbshëm.

Pastai Lazi ë kthver nga Lavdushja në ta noushëllonte dhe aio e kishte vëroafuar. S'kishte ndodhur ta vëroafonte ndoniëherë ndonië vaizë e huaj dhe ai ë afro. ndoshta edhe skurur.

— Ti ie Lavdushia. — kishte thënë Lazi. — Flamuri më fliste shumë për ty. më lexonte letrat e tua. Të donte shumë.

Qerpikët e Lavdushes ishin përpëlitur nja

dy-tri herë dhe pastaj kishin ngrirë ashtu, të hapur.

«Edhe unë, — edhe unë të njoh... Më ka shkruar.»

Lazi u kishte treguar edhe një herë se si kishte luftuar ai dhe si kishte vdekur. Lavdushja kishte qarë me të ngashëryer, kurse nëna s'kishte nxjerrë zë... Lazi ndjeu ta shtynin për të bërë më tutje dhe atë çast u përmend. Pa gruan, nënën e mirë të shokut të tij të dashur, që po i afrohej duke buzëqeshur, ndonëse thellë në sy shquhej dhimbja e fortë e nënës për të birin e humbur, që s'e pa dot dhëndër.

«Ndoshta përfytyron nusen e të birit, — mendoi vërsëri Lazi dhe një therje ndjeu nën gjoks. — Ndoshëta mendon atë çast kur ajo do të futej përkrah të birit dhe njerëzit do të shtinin me pushkë e do të uronin duke përplasur faqoret e rakisë.»

Motra e Lazit i shtrëngoi gruas krahun me dhimbsuri.

— Jam e gëzuar sot, o xhan! — tha gruaja. — E kishte pritur nëna... Eh, sa e kishte pritur... këtë ditë... Të na trashëgohet! — dhe buza prapë iu drodh si një fletë rrahu nga erërat.

Përreth këndonin këngë për nusen, këndonin mirëseardhien që vjehrra i bënte nuses. porositë e sai herë të buta e të ëmbla. si të spërkatura me mjaltë, e herë të rrepta e plot autoritet: këndonin urimin për nië jetë të lumtur bashkëshortore dhe për nië tufë kalamaish që t'u mbushnin vatrën e t'u rinërtérin jetën.

Gruaia me sytë e sai të thellë vështronë dasmorët. Ajo i dinte të gjitha ato këngë. Sa herë i

kishte kënduar nëpër dasmat e fshatit, duke ëndërruar se kështu do të këndonte edhe kur të sillte nusen e djalit, atëherë, pas ushtrisë!... Ushtari i nënës!... Kufitari i nënës!...

Po, që kur ia vranë, ajo s'kishte shkuar më dasmave, s'kishte kënduar më dhe, sikur ta pyetnin një javë më parë për ato këngë, ajo do të ngrinte supet e do të thoshte se nuk i kujtohej asnjë; dhe do të thoshte të vërtetëtë... Po ja që atë çast iu kujtuan të gjitha. Bile, ato këngë ajo po i këndonte, pa vetëdije, në heshtje, përmes ngashërimit të brendshëm. Me hidhërimin e vjetër pleksej edhe ajo ndjenjë gëzimi e përfhtar nga dashuria për shokët e të birit. Se zemra e nënës është e madhe dhe e pafund si deti, ku përzihen ujërat e ëmbla të burimeve që rrjedhin nën vete dhe kripa e hidhur e dallgëve që natë e ditë rreh e s'ndalet duke i kënduar jetës e duke përkundur, si shami të bardha, valët me shkumën e ndritshme të shpresave.

Gratë e kishin futur plakën në mes dhe e mbanin nga krahët. Njerëzit uronin çiftin, këndonin e kërcenin dhe vështronin nga ajo me një merak, që u fshilhej midis syve. Edhe ajo i vështronë. Vështrimet e tyre thoshin: «Mbahu, nënë!» Dhe ajo përgjigjej: «Mbahet nënë!»

Vallja kishte pushtuar tërë oborrin. Në krye të valles ishte nusja. Pas saj, Lazi. Pastaj shumë e shumë të tjerë. Nëna i vështronë me radhë në fytyrë. Të gjithë...

«Po të ishte ai, do të vinte me ty në valle, — mërmëriti ajo duke vështruar Lazin. — Nëna s'ka gjunjë përvallen.» Sytë e tyre u takuan.

Lazi u shkëput, çau përmes turmës së dasmorëve dhe vajti e qëndroi përballë gruas.

— Hajde, nënë! — tha ai duke e kapur nga dora.

Ajo u drodh sikur ta kishte goditur diçka që nga themelet.

Njerëzit mbajtën fryshtë; gërneta lëshoi një tingull të mprehtë e pastaj u ul me ngashërim e u këput; harmonika diç mërinëriti, u hap e u mbyll duke lëshuar në ajër disa tinguj të ngatërruar, memecë. Për një hop gërshtet i valles u shthur e hapat e valltarëve u ngatërruan në aritminë e pasigurisë.

Nëna hoqi shaminë e bardhë nga brezi. Ajo shami e bardhë, në dorën e atij trupi të veshur me të zeza, u drodh në erë si pëllumb i bardhë, i bukur.

— Mbamani! — tha.

Klarineta bëri një rreth të vogël në ajër, si të merrte hov dhe shpërtheu duke ngritur në qielj një luzmë tingujsh, si një tufë shkëndijash; harmonika nxori një melodi të bukur, që derdhej valë-valë, duke mbushur hapësirat me petale lulëfushe, pas tyre me një takт tё rregullt dëgjohej goditja e deficit, ding-digi-ding... ding-digi-ding... bum!... Pastaj, si një valë e gjerë deti, e butë e melodieze, u përhap kënga e vajzave me zërat e kulluar.

Rrethi i valles u zgjat, si një zinxhir shumëngjyrësh, i gjatë e me hallka të fuqishme, tё pakë-putshme.

— Trime grua! — sekush tha.

Të tjerët tundën kokën. Tashmë të gjithë e kishin mësuar kush ishte ajo grua dhe silleshin ndaj saj me nderim e dhimburi. Ajo ishte nëna e Heroit.

Nëna kërcente me shaminë e bardhë në dorë, që e tundte me kursim, sipas ritmit të hapit të saj të rëndë, gati burrëror dhe sytë e saj të mëdhenj qëndronin e glodheshin një hop mbi çdo ftyrë. Këta njerëz deri dje s'i njihnte. Edhe këta nuk e njihnin. Sot ishin bërë të tyret, të afërt e të dashur për njëri-tjetrin. Ajo ishte futur vetvetiu në zemrat e tyre, si të ishte nëna e të gjithëve; dhe ata i qenë futur në lug të zemrës si bijtë e saj.

Vallja mbaroi. Gruaja, e zbehtë e pa një pikë gjaku në ftyrë fshiu djersët dhe shkoi drejt tavolinës së shtruar nën hardhitë. Mori një gotë dhe e ngriti.

— Gëzuar, bij! — uroi ajo me zë të plotë. — Të na trashëgohet Lazi, paçin jetë të bardhë e më rrofshi të gjithë!

Ajo e rrëkelleu gotën me një frymë.

Të gjithë ngritën gotat.

— Gëzuar, nënë!...

— Gëzuar, nënë!...

— Gëzuar!...

Pastaj u kthye nga nusja e nga Lazi, i puthi të dy në ballë e u tha:

— Nëna ju ka shtruar dhomën atje, — dhe bëri me dorë drejt maleve nga kishte zbritur. — Për ju e kam shtruar, hajdeni ca ditë.

Lazi e vështroi nusen në sy. Ajo tundi lehtë kokën në shenjë pohimi.

— Do të vijmë, — tha Lazi.

— Paçi uratën! — tha babai i Lazit. — Të shkoni, si të mos shkoni!...

Nëna buzëqeshi. Ishte një buzëqeshje e ëmbël e gjerë nëne:

NUK ISHTE, VEÇ NJË ILUZION

Ndoshta ishim banorët më të rinj të asaj qyteze naftëtarësh. Ishim katër stazhierë që sapo kishim mbaruar teknikumin e naftës. Flinim në njérën nga dhomat e hotelit të punëtorëve të shfrytëzimit, katër shokë nga katër skaje të largëta, që jeta na kishte mbledhur në atë qytezë të vogël, ku gjelbëronin ullinjtë dhe mëngjeseve përkundeshin me madhështi kurorat e lulëzuara të bama meve.

Peizazhi i qytezës sonë ishte shumë i bukur, njerëzit ishin të gjiltër, ndërsa vajzat, mirësia vetë... Me një fjalë, unë isha dashuruar pas vendbanimit tonë të ri.

— Doemos, — thoshte Koli duke shtrembëruar turirin në një mënyrë tepër komike; — të dashuruarit për ty është fare lehtë.

Koli, që ishte disa vite më i madh nga ne të tjerët dhe që kishte zbritur këtu nga malet e Skraparit, ishte udhëheqësi shpirtëror i katershës.

— Dhe viktimi e kësaj ndjenje të fortë është...
— vazhdonte Koli duke më ngarë.

Resmiu hiqte për një çast sytë nga libri që po lexonte dhe më dërrmonte me atë buzëqeshjen e

tij më të hidhur se çdo ironi e sarkazëm, ndërsa Alqiviadhi, ose «minus njëmbëdhjeta», siç i thoshim ne, pastronte me një kujdes të tepruar syzet e tij me lente të errëta e këndonte një lloj humoreske për kalorësin e vrerosur Don Kishot, dhe emrin e Dylqinjës së Tobozës e zëvendësonte me atë të Idës së bukur.

Unë turfulloja me shaka, ndonëse ndihesha i prekur në sedër.

— Ju, meqë s'depërttoni dot në shpirtin tim, qeshni e talleni, ju...

— Epo s'fluturojmë dot pas teje, — më ndërpiste Koli qetë-qetë. — Ne kemi fatkeqësinë të ushqehemi me çyrek gruri e jo me aromën e bjamëve, si ti, o shpirt fisionik, ne duam të vishemë me stof e fanellatë e jo me kaltërsinë e qiellit kumbues...

— Ti s'ke të drejtë, — e ndërpritja unë gjak-ndezur, i pazoti për të shpjeguar ndjenjat e mia.

Resmiu do të gjente patjetër diçka të ashpër nga «Ushtari i mirë Shvejk,» për ta hedhur pa mëshirë mbi brishtësinë e vajzës që doja, ndërsa Alqiviadhi fshinte syzet dhe pikëllueshëm këndonte:

*Dhe lumi buçiste me këngë e me vaj,
qaj, shelg, o shelg-o, qaj...*

Atëherë nuk isha veçse nëntëmbëdhjetë vjeç dhe, kur e kujtoj atë kohë, tani që kanë kaluar vite, mendoj se ata kishin të drejtë në qëndrimin e tyre ndaj zjarrit tim shpirtëror. Tani e ndiej që isha romantik dhe e dashuroja të bukurën për hir

të vetë bukurisë, në një, mënyrë pasive dhe iluzore. Sa herë kam qeshur më vonë me iluzionet e mia!... Shakatë e shokëve, që mua më dukeshin atëherë cinike, ishin veçse një provë që ata i bënин qëndrueshmërisë së ndjenjave të mia, ishin një lloj frenimi për mua. Ata më afronin, sipas mënyrës së tyre, me realitetin dhe gjithë të mirat e kësaj bote.

— Po përse e do Idën? — më pyetnin. — Mos vallë ngaqë e ka hundën me majë, si ata specat djegës?

Unë zemërohesha me të vërtetë, shaja, përplasja derën dhe ikja. Po më tepër zemërohesha me vetveten, sepse njëherë kisha rënë në dashuri me një vajzë vetëm e vetëm se ajo kishte një nishan nën vetull, që i shkonte shumë. Shokët që e dinin këtë, vetëkuptohet që s'e harronin. Atëherë hidhesha në mbrojtje:

— Jo, sa për dashurinë ndaj Idës ju jeni të gabuar. Kjo nuk është një simpati e çastit, si mund të mendoni ju...

— Po përse, a mund të na e shpiegosh? — këmbëngulnin ata. Unë i vështroja me habi.

— Përse?... C'pyetje pa kuptim!... Sepse Ida për mua është vetë jetë, me bukurinë e saj, — thosha unë. Ata gajaseshin.

— Ulu, ulu ca. se je lart... Ne duam brum, vëlla, mendim të givkueshëm, jo tollombace.

— Këto s'ianë tollombace, — kundërshtoja unë.

— Ato janë ëndrra.

— Mierë kush s'ka të tillë ëndrra! — nxehesha unë dhe largohesha prej tyre.

Po. Ida ishte për mua një idhull!... E bukur,

me dy sy të rrallë, ku çlodhej kaltërsia. E mirë që kishte shoqe vetëm veten!... Ka disa kujtime, që njeriu i ruan gjithë jetën, thellë në vete, me fanatizëm dhe shenjtëri.

Ida ishte gjimnaziste në vitin e tretë. Bënte pjesë dhe në grupin e valltarëve të shkollës. Unë e njoha së pari si valltare. Ajo rrotullohej në podiumin e qytezës me aq zhdërvjelltësi, sa të mahnistë. Në përhedhjen e trupit të hajthëm dhe në lëvizjen e krahëve drejt hapësirës së yjëzuar, dukej sikur gufonte dëshira e ethshme për fluturim. Ajo s'ishte kërcimtare, ajo ishte fillad! Dhe unë u mahnita.

Dilja çdo mëngjes te qoshku pranë stacionit dhe prisja atë të vinte. Ajo shfaqej në shtegun midis ullinjve si një tronditje ngazëlluese. Kalonte me hap të qetë, me kokën paksa të përkulur mbi sup, me çantën nën sqetull. Unë dëgjoja zhurmën e hapit të saj mbi zhavorr, ndieja praninë e saj dhe një dëshirë e çuditshme më pushtonte ta zija prej dore e të dy të vraponim diku larg.

— Mirëmëngjes! — i flitja apo afrohej dhe vija re se si gjaku i vërshonte në fytyrë dhe skuej deri në rrëzët e flokëve, duke m'u bërë kështu një-qind herë më e afërt, një mijë herë më e dashur.

— Mirëmëngjes! — e vazhdonte rrugën. Ah, gjuha! Ajo s'më bindej...

Ajo nxitonte të hipte në autobus. Vegimi zhdukej, e unë rrija te qoshku, pranë stacionit dhe vështroja nga mbrapa si ikte autobusi, duke u lëkundur nëpër gropat e xhadesë, si merrte kthesat me rrapëllimë, si fshihej pas kodrës së zhveshur për të nisur tatëpjetën e Qafës, drejt qytetit të ri të naftëtarëve.

E atëherë dëgjoja brenda vetes:

«Ida».

Po ajo ishte një thirrje që vetëm unë mund ta dëgjoja. Ai emër dyrrokësh, ato tri shkronja të thjeshta gjëmonin pa pushim nëpër thellësitë e qenies sime dhe jehona e tyre e shurdhër mbushte minutat, orët, ditët...

«Ida!»

E ndieja se isha bërë rob i idhullit tim që vetë, me dashurinë time, e kisha ngritur në lartësinë e hyjnive.

Rrija dhe prisja, vështroja i përmallur dhe heshtja. Mbrëmjeve qëndroja jashtë deri vonë. Vështroja figurat e çuditshme të mjegullës nën drithën e argjendtë të hënës, dëgjoja si këndonte, me një zë të mallshëm, zogu i natës, shikoja pllajën dhe numëroja si fikeshin një nga një dritat e apartamenteve të qytezës e pëshpëritja në heshtje:

«Natën e mirë, Ida.»

Në dhomë kthehesha vonë. Zhvishesha në terr dhe shtrihesha, duke u munduar të mos zgjoja shokët. Ndihesha i lodhur e brenga, si një kafshëzë kthetramprejtë e gëzofbutë, afrohej pa u ndier, nëpër terr e ma gjakoste zemrën.

— Hë, more, c'të gjeti? Kthehu andej e kthehu këtej tërë natën e natës, si ai mishi në hell, — ia niste Koli pa hapur mirë sytë.

— Si qebap kafeje, — gajasej Alqiviadhi. Resmiu ia priste:

— Marr guximin t'ju raportoj se fisnikëria e tij ka filluar të bëjë rojë nderi vullnetarisht në krye të rrugës me emrin «Ida». Marr guximin të shtoj,

gjithashtu, se, qysh kur nisi shërbimin fisnikëria e tij, banorët e asaj rruge flenë njëqind herë më të sigurt, përjashto nënët që kanë vajza të rritura.

Ata qeshmin me potere, nxitonin të visheshin dhe përgatiteshin për në sektor.

Unë nuk ktheja përgjigje. Vishesha me nxitim, aq sa shpesh harroja të lidhja këpucët dhe merrja rrugën për te qoshku i stacionit të autobusëve.

Ata, tek niseshin për në sektor, më thërritnin nga larg:

— Ej, kujdes gjalmët e këpucëve...

E iknin në udhëzën mes ullinjve. Unë i vështroja dhe thosha se ishte fat i madh që isha shoku i tyre.

Kështu kaluan muaj.

Një mëngjes shkurti, dhe pikërisht kur mendon se dimrit i erdhi fundi e kur ngjyrat e errëta të tij luftojnë me gjelbërimin e pranverës, qyteza jonë papritur u gdhi e bardhë. Kjo ishte një mrekulli që rrallë shfaqej në këtë zonë. Zbardhët si në përrallë masivi prej dhjetëra hektarësh i tarra-cuar i vreshtave. Ullinjtë kishin përkulur degët nën butësinë e ftohtë të asaj ngarkese. Kudo, mbi çatitë e shtëpive, mbi çiplakëtë kullave të shpimit, mbi kabinet e makinave dhe traktorëve të rëndë, po ajo bardhësi.

Ajo bardhësi e pafund dhe e brishtë më rrëmbushi me një gëzim të madh. Larg, në lindje, ngri-hej Tomorri me malet përreth si një kështjellë e bardhë me tri pirgje.

Nxitova drejt stacionit. Në udhë vraponin, qesh-

nin, rrëshqitnin e rrëzoheshin banorët e qytesës: fëmijë me hundën e skuqur nga thëllimi, gjimnazi të poterexhinj, punëtorët, pleqtë fytyrëmprehtë e hokatarë. Ngazëllimi i kishte pushtuar të gjithë.

Unë isha si i dehur. Qeshja me të madhe dhe ndieja si më buçiste në zemër gjëzimi, thërritja tërë të njohurit dhe një dëshirë e pakuptueshme më shtynte të vrapoja, të vrapoja mbi atë bardhësi... Te qoshku i stacionit tre topa bore fluturuan mbi mua. Ishin ata të tre që më qëllonin: Koli, Resmiu dhe Alqiviadhi.

— O, realistët! — thirra dhe u sula drejt tyre. Edhe tre topa të tjerë bore më goditën duke u shkërmor. U përkula edhe unë të mbushja duart me borë dhe të kundërpërgjigjesha në këtë beteië me forca të pabarabarta. Por, kur po bë-hesha gati të qëlloja, një shuk bore u përplas me forcë në fytyrën time, duke m'i flakur tej syzet. Ishëtë nië goditje aë më hutoi. Kush qëlloi?... Përreth të gjithë qeshnin dhe vazhdonin të më qëllonin. Në atë kor gazmor ndihej, mbi të tjerat, e qeshura e Resmiut.

Koli thirri:

— Edhe një herë. Ida!... T'ia thyejmë syzet endërrimtarit.

«Ida!... Paska qenë Ida?!» — Shtanga unë i habitur, por edhe me një ndjenjë të fshehtë kënaqësie.

Të gjithë qëllonin. Por unë, ulur më gjunië e me duart zhvtur në dëborë, kërkoja syzet. aë drejt e di ku ishin. Dikush m'i solli dhe unë i vura meniherë. Mezi prisia të shihja atë, të mirën, të bukurën, të dashurën, Idën.

Përreth qeshnin. Diku, mes atyre qeshjeve, ishte edhe zëri i saj. Fshiva syzet me shall dhe gjithçka u qartësua në çast. Bota ishte e bukur. Unë isha midis saj, nën trajektorët e topave të borës, si nën trajektore kometash të bardha, që fluturonin përreth meje, në një valle gjëzimi. Bota ishte e bukur dhe unë isha midis saj dhe kërkova Idën.

Dhe ja ku ishte!

Në sytë e saj, ku zakonisht çlodhej kaltërsia, tani përshkëndiste dielli. Më qëlloi edhe një herë, pastaj vrapi tutje, nën degët e ullinjve, duke lëshuar në ajër klithma ngazëllimi.

Ajo sulej si shigjetë mbi ledhet, lëshohej tätëpjetë brinjave, dredhonte midis njerëzve dhe trungjeve, dhe ajri kumbonte e dridhej si një kampanë nga të qeshurat e saj.

Unë e ndiqja. Mbaja midis pëllëmbëve një shuk bore që shkrinte e zvogëlohej pak nga pak. Doja të qëllaja edhe unë, të vazhdoja atë lojë që ajo vetë **kishte** nisur...

Dhe e kapa.

Bora më rroddhi nga duart: në vend të ftohtësisë së saj, tani shtrëngojë supet e brishta të Idës, që dridheshin nën pulovër.

Ajo më vështronëtë në fytyrë dhe qeshte.

— Ida!...

Ajo gjithmonë më vështronëtë në fytyrë dhe qeshte. Pastaj, për një çast u hepuar nga unë si për t'u mbështetur, si për t'u çlodhur, si për t'u mbushur me frymë para një shpërthimi të ri të ngazëllimit. Ky ishte vetëm një çast, një çast kaq

i shkurtër, sa unë, sigurisht, s'do ta besoja po të mos dëgjoja zérin e Resmiut që thërriste:

— Një fotograf!... Të vijë shpejt një fotograf!

Dhe Alqiviadhi që deklamonte me ton patetik:
«Kjo botë u shthur. O prapësi, o dreq!...»

— Ida!...

Ajo qeshi. Papritur m'u shkëput nga duart dhe vrapi i tutje, mes njerëzve, trungjeve dhe hapësi-rave të bardha. Në zemër më mbeti një peshë e papërcaktuar. Diçka midis lumturisë, trishtimit dhe humbjes.

...Kaluan ditë, kaluan javë dhe muaj.

Çdo mëngjes Ida shkonte në shkollë dhe çdo mëngjes unë qëndroja diku te qoshku i stacionit.

— Mirëmëngjes!

Dhe ajo, e skuqur e tëra, përgjigjej:

— Mirëmëngjes!...

Pastaj hipte në autobus. Unë psherëtija. Vë-shtroja autobusin si ikte duke u lëkundur dhe thërritja në heshtje:

«Ida!...»

— Një vajzë tetëmbëdhjetëvjeçare është përherë ca më e madhe e ca më e pjekur nga një djali po i kësaj moshe, — tha një herë Koli dhe më vështroi gjatë në fytyrë, me një lloj dashurie përzier me keqardhje.

«Një vajzë tetëmbëdhjetëvjeçare është ca më e madhe... është ca më e pjekur nga një djali po i kësaj moshe.» Unë s'e pata kuptuar ç'deshi të thoshte.

Po mbas ditës që luajtëm me borë gjithçka ki-

shte rrjedhur si është më parë: ajo shkonte në shkollë dhe kthehej; unë dilja te stacioni dhe e vështroja; ata të tre, Koli, Resmiu dhe Alqiviadhi vazhdonin të më ngitnim e të qeshnin.

Ndërsa mua më pëlqente vetmia dhe në orët e muzgut qëndroja mbi gurët plot myshk të kalasë e netve, duke u rrotulluar në shtrat, èndërroja shpesh e më shpesh të binte përsëri borë.

Po kishte ardhur pranvera...

Dhe, ndërsa përreth gjithçka po bleronte e po lulëzonte, një aromë e lehtë e këndshme lulesh kishte parfumuar qiellin e tokën, e gushëkuqët, si të dehur, hidheshin degë më degë, këndonin e shpupuriteshin, unë vazhdoja të isha i trishtuar, i zymtë. Pranvera, që zhduku çdo mundësi për një borë të re, s'më kishte afruar asnjë hap me Idën. Shëtitja nëpër ullishtet buzë udhëve dhe faqeve të kalasë, në mugëtirën e netve, vështroja botën përreth, konstelacionet e largëta të yjeve, nuhatja aromat e këndshme dhe të papërcaktuara të tokës e, vetvetiu, si një zë i thellë, i brendshëm më shfaqej një emër, si një thirrmë: «Ida...»

Një natë, ndërsa hanim darkë, Resmiu më pyeti:

- S'paske shkuar në mbrëmje?
- Në ç'mbrëmje?
- Në gjimnaz, — tha Koli. — Atje është Ida. Nuk shkove ta shihje tek vallëzon?
- Me djem të tjerë, — ia priti Alqiviadhi.
- Sepse ty s'ta mban t'i afrohesh, — Resmiu kësaj herë m'u duk se foli seriozisht dhe kishte thënë të vërtetën.

Përplasa pirunin pas pjatës dhe u çova e dola.

«Jam njeri pa kurajë, — thashë me vete, — dhe keni të drejtë të qeshni.»

Isha zemëruar me veten, me pazolësinë time për ta ndalur e për të biseduar me të, me druajtjen time, që, ndoshta, mund të më kishte bërë edhe qesharak në sytë e saj. «Ta marrë dreqi, — shava dhe u nisa tatëpjetë rrugës, pa asnje qëllim. — Nesër do të bisedoj patjetër me të.»

Po kjo nuk ishte hera e parë që merrja një vendim të tillë.

Kisha kaluar bufenë te stacioni dhe po shkoja, fare i vetëm, nëpër xhadënë e gurtë, që të shpinte në qytetin e ri. Nëpër shtyllat e drunjta shkëlqenin dritat elektrike. Frynte pak erë e llambat lëkundeshin; lëkundëj dhe drita e tyre, lëkundëj dhe hija ime. E shihja atë nëpër gurët dhe zhavorrin e udhës, herë pas meje, herë anash e herë përpara. Kapérceva diku kanalin anësor dhe u ngjita mbi një sop, nga ku dukej krejt udha. Nuk di sa qëndrova në atë sop të errët e përse mendova. Di vetëm që bota m'u duk shumë e madhe, shumë e bukur dhe vetja përballë saj një fije e dobët bari. Pikërisht në një gjendje të tillë shpirtërore pashë së largu një çift, që vinin përqafuar nëpër udhën e përpjetë. Ata ecnin ngadalë dhe dic bisedonin nën zë. Sigurisht diçka të bukur për këtë mbrëmje, për këto ditë e net pranverore. Vështroja siluetat e tyre dhe ndieja nëpër gjithë qenien time si rridhët pak e nga pak një curril i hollë, i ëmbël, dehës. Cilët ishin s'i njoha, po ndjeva se ishin të lumtur.

Ata afroheshin. Unë rrija dhe vështroja. Buzëqesha. I buzëqesha lumturisë së atij çifti të pa-

njohur, që shkonin përqafuar nëpër natë. Ata kishin ardhur fare afër, pothuaj nën sopin ku kisha qëndruar. Po fytyrat nuk ua dalloja. Kurse zërat tani më vinin pothuajse qartë.

— Kur erdha për punë prodhuese në oficinën tuaj dhe më caktuan të punoja me ty, të them të drejtë as që ma mbushe syrin fare, — thoshtë vajza.

Ky zë... Ky zë... Oh...

Papritur diçka shungulloj me krismë në gjoksin tim, sikur u thye një send i fortë e solid e më cau kraharorin.

Ky zë është i... Idës... Ajo, që shkonte përqafuar me atë djalë, ishte... Ida... Ida... Pa shih se ç'paska qenë...

Gjithçka e bukur dhe e njerëzishme ishte tkurrur përbrenda meje deri në hiç, e zemrën po ma ndrydhte e po ma shtypte një peshë e rëndë.

Ata kaluan pa më vënë re dhe ikën tutje, drejt kthesës së xhadesë. Unë i ndoqa me sy dhe pëshpërita:

«Pa shih!... Pa shih q'na qenka...»

Ndihesha i fyter, i tradhtuar, i braktisur. Përherë e më shumë diçka po më zinte frymën.

U çova i dërrmuar dhe mora një rrugë tertiore. Pastaj u ktheva prapë e dola në xhade. Ata s'dukeshin më. Ecja nën llambat që i lëkundte era dhe vështroja i menduar hijen time si zvarritej e hidhej sa para, anash e prapa. Isha i pikëlluar dhe gjithçka atë mbrëmje po më dukej e hidhur, e fshehtë.

«Po kush më kishte tradhtuar, vallë? Çfarë më kishin grabitur? Kush më kishte gënjer?...

Askush!... Ah, jo! Unë vetë kisha gënjer, për shumë kohë, vvetven. Dhe tani, që shihja realitetin, ai po më dukej i hidhur, i pabesë, gënjeshtar.»

Kjo botë u shthur...

— Hë!... Posi, u shthur... Më të lumtë, moj Idë! — thirra me zë të egër sikur kërcënoja dikë në terr. — C'ma bëre mirë! E c'isha unë për ty, në fund të fundit? Askush! Një njeri që rrinte dhe vështronë nga larg bukurinë e syve, hijeshinë e trupit dhe të valles. Një njeri që kishte luajtur një ditë me ca topa bore dhe rrinte e mallëngjehë pastaj, pa guxuar të të afrohej. Dhe pastaj më vjen hidhur...

Tani e kuptova mirë atë fjalën e Kolit.

«Përse të pëlqen Ida, — thoshte Koli. — Ti as që e njeh atë.»

«Do njihemi, — thosha unë, — me kohë, vetëjeta do të na njohë.»

«Po në rast se më kohë, kur jeta t'ju ketë njohur me njëri-tjetrin, do të kuptioni se keni gabuar. q'do të ndodhë atëherë?»

Unë kisha heshtur pa ditur q'të thosha.

«Ose do të ndaheni, ose, akoma më keq, do të qëndroni pranë njëri-tjetrit si dy të huaj, e prania e shoku-shokut s'do bëjë asgjë tjetër. vec do t'ju kuitojë sa mendjelehtë jeni treguar dikur», thoshin ata.

«Eh!...», psherëtiva.

Në mesnatë mora rrugën për në fjetore.

* * *

Që atëherë ka kaluar shumë kohë. Shumë ngjarje kanë ndodhur në jetën time e shumë ndryshime kam pësuar. Ida nuk di ku ndodhet. Po herë-herë më pushton për të një mall i madh. Shokët e dinë këtë dobësi dhe ndonjëherë më thumbojnë. Qeshim. Alqiviadhi, gjithmonë po ai Alqiviadh, ndonëse tanë është kryeinxhinier në një ndërmarrje të naftës. Sa herë takohemi këndon nën zë, me një timbër të lehtë pikëllimi, atë këngën që unë pata shkruar dikur e që fillon me vargun: «Asgjë nuk ishte, veç një iluzion...»

LULE DJEMTË E NËNAVE...

Novelë

Çuka ishte kufiri. Në jug të saj shtrihej pushteti i Këshillave Nacionalçlirimtare. Në veri ishin armiqtë e tij. Pas një rrethimi të gjatë pushtuesit nisën, më në fund, operacionin e tyre të egër kundër këtij kufiri. Çuka ishte edhe rrugë kalimi.

— Kush ka Çukën, ka fitoren! — tha komisari i batalionit partizan.

Batalioni marshonte me ritëm të shpejtë. Bora ishte një metër e trashë, një borë e ngrirë, që kërciste si akull nën opingë; qielli i hirtë e i ftohtë, sikur përgatitej për të hedhur borë të re.

Mëgjithëse qe ftohtë, partizanët e batalionit partizan s'e ndienin, përkundrazi ishin djersitur.

— Më shpejt!... — urdhëroi komisari i batalionit.

Gjerdani i gjatë i kolonës u sul me vrull drejt veriut, drejt Çukës.

Kaluan Vaun e Drerit dhe, si dredhuan Buzën e Shkëmbit, ranë përtej Sopit, çanë pyllin e

„bredhave e dolën në të përpjetën e zhveshur të Strallit.

«Kush ka Çukën, ka fitoren!» — mendoi përsëri komisari.

Ai ishte pothuaj çunak, ndonëse shpatullgjerë, një pash larg supin nga supi. Mustaqet e rënda ia rritnin moshën. Kishte dhjetë vjet pa shkelur këtyre anëve, që atëherë kur patën bërë gjyq me fshatarët e Shqoposit për kufijtë, megijthatë i njihite mirë këto vende. Ja, aty në Çukë u kishin bërë pritë, i kishim qëlluar me dyfekë një copë herë të gjatë dhe patën vrarë një nga të fshatit...

„Që atëherë!

Mirëpo kjo, lufta e fundit, sikur i harroi gjakrat. Ky hasm i madh, i cili erdhi që përtej detit e që përtej maleve, i afroi njerëzit, i bashkoi fsharat dhe krahanat, ja, ashtu si bashkohen gishtërinjtë kur shtrëngohen pas hekurit të pushkës... Në batalion ishin gjashtë partizanë nga Shaopasi e njëmbëdhjetë vieri fshatit të tii. Bashkë qëndronin e bashkë luftonin, e kafshatën e bukës e ndanin me niéri-tietrin. Vellezër e shkuar vellezërve, c'i do fjalët!..

Ai ktheu kokën prapa si të donte t'i shihë të gjithë në sv. vor s'i na dot. Kolona gjarpëronte me bishtin te Guri i Cjapit.

Për njëfarë kohe vështrimi i tij ra përtej bardhësisë së borës, në fushat buzë lumi. Fshatrat s'dukeshin nga mjegulla, vor ai e dinte që ata ishin atje poshtë, nën mjegull. Dhe pushteti i ri, ai i zhatharakëve, jetonte e merrte frymë, lëvizte nën ato pullaze, midis atvre shtëpive të rënda prej guri, në ato udhë të përbaltura.

Ai kërkoi me mendje midis atyre fshatrave Luginasin, prej të cilët ishin nisur atë mëngjes. «Njerez fare të këputur, — mendoi. — S'kanë tjetër pasuri dhe gjëzim veç pushtetit të ri dhe shpresës... Besa, pasuri të madhe kanë!...»

Telo borizani u koll përsëri khë-khë!... dhe pështyu.

Në dorë mbante një bori. Ai ishte çunak. Fytërën e kishte të verdhë, më të verdhë se tunxhi i borisë, ishte fjalëpakkë, ndaj dhe shokët thoshin: «Telo borizani vetëm me bori di të flasë!...». Dhe kishin të drejtë.

Komisari ecte me vrull përpara. Telo borizani kollej, pështynte dhe ecte ngjitur me të. Mbas tyre lëvizte batalioni.

Kishin katër orë që marshonin me këtë ritëm, katër orë pa pushim pothuaj fare.

«Ata na kanë rrrethuar nga të katër anët, — mendonte komisari. — «Ju keni deklaruar se do t'i ktheni në legjendë qafat dhe grykat e këtyre maleve, thonë ata, dhe kokën, kurrizin nuk do t'i ulni kurrë, ashtu sikundër nuk i kanë ulur më parë gjyshërit dhe stërgjyshërit tuaj... Edhe pak kohë, oh! Prisni edhe fare pak... Kur të vijë pranvera, bardhësinë e borës do ta zëvendësojë një tjetër bardhësi: ajo e eshtrave tuaja... S'do të ketë më qytete, s'do të shfaqen më papritur midis pyjeve apo në brinja fshatrat tuaja të vogla, kullat e bardha dhe të vëtmuara si karakollë të bardhë, të mbetur kushedi nga ç'kohë; s'do të ketë më stane dhe lokalitete!... vetëm gurë do të ketë, gurë të bardhë nga të muranave dhe eshtra nga tuajat. Ne do ta kthejmë tokën tuaj në shkre-

tëtirë malore. Ju guxuat të na kundërshtoni, ju na goditët.... Ne do t'ju shfarosim. Ky do të jetë fundi i qëndresës suaj të përbindshme dhe monumenti më madhështor i hakmarrjes sonë...» — deklarojnë ata... Shajnë, kërcënojnë, por pas kërcënimit dhe fyerjes, fshihen përherë frika dhe pasiguria...

Komisari futi në gojë një copë borë dhe pastaj e pështyu.

Mbi kokat e tyre ngrihej Çuka.

— Më shpejt!... — urdhëroi komisari.

Elmazi nga Shqopasi, Elmaz Katanaja, rrëshqiti e u rrëzua shul. Shau nëpër dhëmbë e u ngrit, duke rregulluar më mirë pushkën.

— Bir, o bir!... T'u këputën shtyllat... — qeshi pas shpine Kalo Nishani.

Elmaz Katanaja turfulloi.

— Lipsu!... Kohë për të qeshur gjete!...

Kalo Nishani, kokëvarur, vështronë gjurmët e mëdha të Katanasë. Ashtu të stërmëdha, ato të sillnin. në përfytyrim gjigantët e legjendave.

Kalo Nishani qeshi nën buzë dhe diç deshi të thoshte për ato putra që futeshin nën dëborë, po Xhuzepe Fiorentini tha me atë shqipen e tij:

— Shoku Kalo, aprovoja fjala ime: Albania bukturia rralla, ashpra, bukuri, tipika Ballkana!...

Kalo Nishani hodhi në supin tjetër mitralozin e tij «Breda». Xhuzepe Fiorentini, ose Xhuzepe mortajisti, siç i. thoshin në batalion, hodhi edhe ai në supin tjetër grykën e zjarrit të mortajës së lehtë. Pas Xhuzepe vinte xha Dulja. Ai pyeti:

— Xhuzepl, a do të bëjë punë ajo firaune atje sipër?

— A?...

Italianit nga tē ftohtët fytyra dhe duart i ishin mavijosur.

— Ja, pér mortajën flas, — sqaroi xha Dulja.

— Shumë punë! — u përgjigj italianini. — Në distancë vogla mortaja arma mirë...

— E di, e di, — xha Dulja fshiu djersët me një dyshe plot thekë. — Jepu këmbëve! — tha pastaj.

Tutje, nga e djathta, si një kështjellë vigane, mes mjegulle, ngrivej Qafa e Arushës.

— Qafa e Arushës, — tha Drita. — Thonë se nga një plasë shkëmbi kullon mjaltë... Po ai mjaltë, thonë, nuk hahet. Është i përzier me rrëshirë pishe dhe askush s'e ha! — vazhdoi ajo.

Kalo Nishani ndiente uri. Dhe në zërin e Dritës ndihej një lloj keqardhjeje.

Kolona ngjiste me ngut tē përpjetën e gjatë e tē zhveshur tē Strallit.

Në gërxhet e Vrimave tē Ujkut, Dule Gropës i shkanë llastikat në dëborën e ngrirë dhe mori tatëpjetë.

— Shoku xha Dula — a!... — klithi italiano.

Zëri, një përzierje dhimbjeje, çudie e tmerri, si një klithmë alarmi befasoi zemrat e luftëtarëve të kolonës.

Ata u kthyen nga ajo pikë e kolonës ku duhej tē ishte xha Dulja po ai nuk dukej.

...Xha Dulja ishte në rrezik.

Poshtë këmbëve tē tij, ndo njëqind metra më tutje, grykëhapur, e mjegullt, e frikshme qëndronte humnera.

Ai u pérpoq tē ngekte diku, pas ndonjë guri a

ndonjë dege, por nuk arrinte; gjithçka ishte mbështjetë nga débora.

«Qefin i bardhë» — mendoi plaku. Atëherë u mundua të fuste në ndonjë kllapë thëmbrat e llasistikave, por ato, të ngrëna, siç ishin, nga udhët dhe guri, s'bënин vend në atë shtresë të ngrirë. Për herë të dytë i brodhi nëpër mend, si një përshkënditje, se ajo bardhësi e paanë ishte qefini i tij.

«Për këtu e pata të thënë! — mendoi ai me dëshpërim, — gjynah!»

Trupi rrëshqiste gjithmonë; jo shpejt, po me gjithatë rrëshqiste drejt humnerës.

Plakut iu kujtua arma. Ta ngulte në déborë dhe të mbahej pas asaj, si pas një huri. U rrotullua në ijë... por armën nuk mundi ta nxirrte. Ajo ishte nën gunën që i vinte prapa, osh nëpër déborë.

Atëherë u dëshpërua dhe, ashtu vetvetiu, mendoi përsëri fundin e tij.

«Për këtu më qenka shkruar, të shkretën?...»

Papritur, diku anash tij rrëshqiti një hije e zezë, e stërgjatë. Xha Dulja nuk arriti të mendonte ç'ishte ajo hije, që vraponte më shpejt se ai, po në atë drejtim, drejt vdekjes.

Një zë thirri urdhërues.

— Kapu pas meje, Dule!

Pa vetëdije ai kishte zgjatur duart për t'u kapur tek ajo hije dhe, kur e kuptoi ç'thoshte zëri, ishte mbërthyer fort pas diçkaje që duhej të ishte kofsha e atij që i rrëshqiste përbri. Elmaz Kata-naja rëndoi me tërë fuqinë dhe peshën e trupit të tij mbi bajonetën e gjatë që mbante në dorë dhe ajo u ngul e tëra në déborë.

U mbajtën të dy pas bajonetës.

— Shpëtuam! — tha me një psherëtimë Elmazi.
Xha Dulja vështroi fytyrën e shokut.
— E po...! — tha ai me një fije zëri.
— Hiqi llastikat! — urdhëroi Elmaz Katanaja,
— dhe shkel mbi gjurmët e mia!

Dhe u nisën të dy, njëri pas tjetrit, përpjetë, drejt shokëve.

— Më paska rënë qylafi, — u dëshpërua plaku, kur arritën lart.

— Ashq vërtet, po të shpëtoi koka, ama, — tha Kaloja. — Ndaj, tund kutinë të dredhim nga një duhan.

Dule Gropa vështronte shokët një për një në fytyrë dhe buzëqeshi. Xhuzepe Fiorentini i vajti pranë.

— Vishe opingat. — tha ai. Pastaj shtoi, sikur ia thoshte vetes: — Elmazi shumë inteligjent! Guximtar shumë! Eh, trim, ka guxim.

Nierëzit nuk flitnin.

Ka disa çaste kur heshtja shpreh më shumë se çdo fialë.

Komisari i shtrëngoi krahun Elmaz Katanasë pak më sipër bërrylit dhe tha ngadalë, qetë e shkoqur:

— Nuk na lejohet të vdesim nga pakujdesitë, shokë... Dhe tani, të nisemi!

Dhe u nisën.

Nisën të ecnin më shpejt, se donin të fitonin kohën e humbur.

Pas pak, aë atje përtej, Kalo Nishani nisi një këngë si vajtim:

*Desh e le plakën kërcure,
Dule Gropa me poture...*

Shokët vetëm sa vunë buzën në gaz.

Ende ishin nën pushtetin e tmerrit dhe të habisë.

Po Kalo Nishani, si gjithmonë, do të gjente një pikë ku të tirrte qyfyret e veta dhe t'i bënte shokët të gajaseshin.

— Xha Dule, pse të qenkan lagur poturet në shtrat? Mos të shpëtoi gjë tek rendje tatëpjetë?

Një e qeshur e fortë shpërtheu nga gjokset e atyre. Qeshnin...

Po, qeshnin. Më shumë se me shakatë e Kalo Nishanit ata qeshnin nga fakti se xha Dulja ishte midis tyre. se Elmaz Katanaja u hodh në grykën e vdekjes dhe i shpëtoi jetën. A nuk ishin hedhur dhe ata të gjithë mbi grykën e ftohtë e të egër të vdekjes, për të shpëtuar jetën? A nuk ishin kapur fort pas pushkës e bajonetës për të ngjitur lart, drejt lirisë këtë truall të lashtë, të brejtur nga lëngata?...

Edhe xha Dulja qeshte sa shavhei.

— Nga dëbora. o djall me brirë. nga dëbora. — shfaiësohej ai.

Ata ngjiteshin e ngjiteshin. Si kaluan Pérroin e Gështeniave. morën të përprietën e Gurit +ë Kuq. Dëbora dhe e përpjeta e vështirësonin miaft ecien.

— Të laimërohet komisari se mushkat mbetën në horë...

Laimi. i shnejtë si një vetëtimë, pëershkoi dhe mbërriti në krve:

— Të laimërohet komisari...

— ...mushkat mbetën...

— ...në dëborë!

Shqetësimi i të gjithëve u përqendrua në fund

të kolonës, atje ku lindi së pari, tek ato tri mushkat e kuqe ngarkuar me municion dhe mitraloza të rëndë. Ishin fundosur...

Nga kreu drejt fundit mbërriti një urdhër tjetër:

— Mitralozat dhe municioni të mbarten me krahë!

— Të mbarten mitralozat...

— ...dhe municioni...

— ...me krahë!

Në rregull... ndërgjegjja e njësuar e batalionit getësohet. Dhjetëra këmbët e tij lëviznin energjikisht drejt veriut.

— Më shpejt! — fliste komisari. — Se mos humbasim kohë....

«Po në luftë ajo vlen më shumë se floriri...»

Më shumë se i tha ai i mendoi këto të gjitha. Patjetër i mendoi. Telo borizani, që vinte përbri tij, nuk dëgjoi të tjera fjalë veç atyre që ishin përsëritur disa herë gjatë atyre orëve: Më shpejt!... Më shpejt!...

Telo borizani përsëri u koll dhe përsëri pështyu gjak mbi borën e ngirirë.

Komisari e vështroi me bisht të syrit dhe iu dhimbis. Nga i gjente gjithë ato energji ky trup i sëmurë e i sakatosur?.... Kollej, pështynte gjak, megjithatë kurrë nuk ankohej, kurrë nuk ndalej!...

Telo borizani ishte jetim, fill i vetëm në botë. Ishte nga Jugu, nga vendi i diellit dhe i detit. Teloja fliste ngadalë, me zë të pakët e me fjalë të kursyera për qytetin e tij të gurtë e të bardhë, që, mes purpurit të mbrëmjes, dukej si i varur

në shkëmbinj... Fliste për vogëlinë e tij, punët e ndryshme që kishte provuar si gurgdhendës, qymyrxhi, kishte punuar dhe në punishten e vajit. Kudo, nëpër bisedat e tij, shfaqej dielli dhe deti, si dy miq të dashur e të papërlyer.

Ai, ndonëse ende i ri, kishte provuar e vuajtur shumë, po nuk fliste kurrë për hallet dhe vuajtjet.

Teloja tregonte, shokët e dëgjonin dhe i rrëmbeante tregimi i tij i shkurtër dhe i thjeshtë, ashtu si të rrëmbyen melodja që lind nga lëvizja e rrëmbyer e kallamave dhe shelgjeve kur nis e frys juga eëmbël.

Telo borizani ishte i dashuruar pas natyrës së bukur dhe s'përtonte ta përshkruante me zjarr.

«A ka gjë më të bukur sejeta? Sot na e kanë nxirë, vërtet, po më vonë, pas lufte kemi për të parë sa e bukur do të jetë!»

Kudo, kurdoherë ai i thoshte këto fraza. Ato qenë bërë epilogu i tregimeve të tij.

— Si thua, do të kemi edhe nga ata të Ballit përpëra? — pyeti Elmazi.

— Jo, — tha Kalo Nishani. — Kemi vetëm gjermanin, helmetat me kryqe të thyera. Të gjithë trima të zgjedhur... Po ti mos u tremb...

— Ik, ore ti! — shfryu me shaka Elmazi. — Elmazin vetëm një gjë e tremb: mos i sosen fishekët.

...Kalo Nishani e dinte mirë që Elmazit nuk i trembej syri. Po ai ashtu e kishte: taljej e qeshte me të gjithë. Kush nuk e njihte mirë, gabohet me Kalo Nishanin. I dukej si një njeri që s'para e vriste mendjen, që rrëshqiste në jetë si me patina.

Po shokët e njihnin mirë dhe e dinin se ç'fshihej pas atij qëndrimi hokatar.

Kalo Nishani kishte pasur një shtëpizë, 'një grua që përgjerohej pér të dhe një të vogël, por s'i kishte më... Kriminelët e Isa Toskës si ia përdhunuan gruan, ia çanë me thikë, ndërsa shtëpisë i vunë zjarr dhe foshnjën ia hodhën midis flakëve. Po Kalo Nishani s'e kishte lëshuar veten, kishte vazhduar të bënte shaka si më parë. Veç në betejë, kush i ishte ndodhur përbri dhe e kishte parë tek luftonte, thoshte më vonë se Kalo Nishani kishte tèrbimin e rrufesë e, kur qëllonte me Bredën e tij, përsëriste nëpër dhëmbë emrin e gruas dhe të fëmijës...

Kishte ndodhur që Kalo Nishani të luftonte një me dhjetë, si burrat, pa iu dridhur dora e pa iu trembur syri... Dhe komandanti kishte thënë:

— Në qoftë se zotësia pér të mbajtur veten para rrezikut më të madh përbën thelbin e guximit dhe të heroizmit të njeriut, atëherë, vëllezër, unë them se Kalo Nishani është trim dhe hero!...

— Atë frikë, o Maze, e kemi të gjithë, — tha i menduar Kaloja. — Sepse municioni pér të téré është i paktë.

Një copë herë heshtën. Dëgjohej dëbora që thyhej e ngjishej nën këmbë, frysëmarrja e shpejtë, ndonjë kollë e thatë dhe zhurma karakteristike e marshimeve, e fërkimit të rrobës me rrobën, e përplasjes së lehtë të armëve me kallamin, të bombarave me pagurin.

Brinja ishte tepër e pjerrët dhe fâre e zhveshur, me përjashtim të ndonjë kacube, që, e mbuluar prej borës, të krijonte përshtypjen se s'ki-

shtë gjë tjetër veç duna bore të krijuara nga era. Vetëm diku, në një gropë ngrihej e gjerë një pishë e vëtmuar, plot kristale, rënduar e kërrusur nën peshën e bardhë.

— Oh, ç'bukuri! — psherëtiu Drita.

— Fantastike! — pëshpëriti i mahnitur Xhuzepe Fiorentini. Ajo pishë e vëtmuar, e mbuluar me borë e me kristale nëpër degët, i kishte sjellë në mendje vendlindjen.

...Një carro. Më tej tezga. Pranë saj një grua, eëma. Sytë e saj, vetëm sytë... Pastaj gurorja. Dialogu i daltës me gurin, dialog i lashtë, plot të fshehta. Duart e babait plot të çara nga ciflat...

...Xhuzepe Fiorentini shkelte mbi dëborë me sytë ngulur gjithmonë në një pikë dy hapa para vërvetes. Mbi borë u ravijëzuan linjat e një fytore të dashur: Patricia!...

Ai psherëtiu... Patricia e bukur, me dy gërshtetë gjatë nën drurin e portokallit... Patricia e qeshur e fermës së portokajve... Patricia me sy të bukur si lulet e portokallit!... Patricia dhe... padroni. Qejfet e tij të shthurura, ku mbytej së paku nië piesë e frikës nga e nesërmja... Padroni dhe Patricia... Pastaj thika, thika dhe padroni është plasur për tokë. Më pas burgu. dhe ai i vetëm në atë qeli të ftohtë dhe të egër! Duke dashur të nxirrte nga poret e zemrës së tij vrerin e hidhur të mërzisë, ai këndonte. Ashtu i ndiente shpirtin më të aqëtë dhe mendimet më të kthiellëta. Vështronë muret e ftohta të aqësë së lagët. që kuterbonte erë të rëndë...

...Duke shkelur mbi borën e ngrirë me ato kënuçë të çuditshme në këmbë. të sajuara me

gomë makinash, Xhuzepe Fiorentinit i shfaqeshin para syve kopshtet e përgjumura të Sicilisë së dashur, muzgjet ëndërrimtare pranë dunave dhe palmave... kujtime të së kaluarës.

Partizani plak, Dule Gropa, me mollëza paksa të dala e me mustaqe që merrnin përpjetë me njëfarë vetëkënaqësie pak të tepruar, ngjitej përpjetë. Gunën e kishte hedhur pa kujdes mbi sup, a thua se nuk shkonte në luftë, por me dhi. Vështronte italianin që çapitej para tij me atë kapotë të gjatë deri në fund të këmbëve, dhe mendonte, duke tundur kokën: «Çudi!... Për ideal, çudi!... Erdhi i biri i botës të luftonte kundër meje e kundër teje, e nashi është shoku ynë, dhe bashkë me ne vjen e zë, mes kësaj bore e këtij acari, shtegun nga pritet të hyjë murtaja e ligë...».

E iu kujtuan fjalët e komandantit «Popujt janë ngritur me armë kundër fashizmit». «...Pooo!... Edhe ky bir populli është, fukara njeri. Komandanti thosh të vërtetën... Ç'e do, s'ishte në këtë luftë!... I qe hapur plaga për ibret dhe e kishin çuar në spital... Megjithatë nuk e bënë mirë italiannët që erdhën te ne, jo!... Nuk duhej të kishin ardhur!... Flas për ata që janë si puna ime, buiajt e punëtorët... Ata nuk duhej të vinin! Të ngrishin e t'i binin mbretit, po të qenë të zotë.. Nejse...»

Kolona ecte në nië rrafshinë, në nië si luat midis lartësisë që kishin ngritur dhe asaj në duhej të ngjitnin. Atv batalioni partizan u nda në tri kolonë. Cdo kolonë, nië kompani, cdo kompani me nië detvrë të vërcaktuar mirë.

Në kompaninë e qendrës ishin komisari i ba-

talionit dhe zëvendëskomandanti i batalionit, Ukë Ukshini.

Ukë Ukshini kishte qenë bari delesh, dhe kishte një shtat të lartë.

Në Veri, më shumë se kudo, lufta e njeriut me natyrën ka tingëllimin e baladave. Ashpërsia e natyrës, e motit, ashpërsia e jetës lënë gjurmën e tyre në karakterin, temperamentin, psikikën dhe fisionominë e njerëzve...

Dhe tek Ukë Ukshini dukej qartë kjo përshtatje, si e sintetizuar shquhej bota veriore.

— Qysh kur u krijua ky rrafsh i borës, kurrush më shpejtë s'ka ecë mbi të, por, me pasë do rrathë prej druni, tri herë më shpejt do të kishim mbërritur! — gjëmoi zëri i Ukë Ukshinit.

Sytë e tij në të blertë të thellë shkreptinë e për një të dhjetën e sekondës dy xixa, si dy zjarre të fugishme, u pasqyruan në ekranin e tyre të gjelbër e nisi të këndonte me zërin gjëmimtar:

*Me gjoks çeliku para shkon,
si një rrebesh kudo shpërthen,
armikun ti e shkatërron,
dhe vdekjen i rrëfen.*

Mbi atë hapësirë të ftohtë kënga u ngrit laftë si një shpend malesh. Mbi të tjerët, i pastër, dëgjohej zëri i italianit Xhuzepe Fiorentini.

— E kanë për xhins këngën këta! Këndo, o Xhuzepe, të këndoftë zemra, — mërmëriti Dule Gropa. — Kjo luftë e nëmur na bëri shokë. Tani jemi shokë!... Ti e ke fituar me gjak këtë të drejtë,

që të këndosh një këngë me mua... Këndo, e të këndoftë zemra!...

Drita, partizania sanitare, e hollë dhe e hajthme, këndonte dhe rregullonte në ecje flokët e saj të shprishur...

Kalo Nishani shtrëngonte në grusht një shuk bore, e cila në fillim u ngjesh, pastaj ngriu. Ngrinë mbi të dhe gjurmët e gishtërinjve të tij. «Si kokodashe» buzëqeshi Kalo Nishani dhe ndjeu uri.

* * *

Papritur, shapkat, supet dhe shpatullat e partizanëve filloi t'i mbulonte një borë e imët si e shkuar në sitë. Borë e ngrirë.

Po kjo askujt s'i bëri përshtypje. Ata ishin burra të fortë, që kishin kaluar dhe dimra të tjerë jashtë.

Po ngjitnin të përpjetën e fundit. Larg, nga e djathta u dëgjuan të shtëna.

— Shokë, më shpejt!...

Nuk ecnin, por vraponin.

Tërë muskujt e tyre ishin tendosur në një drejtim. Vështrim i tyre i brendshëm ishte përqëndruar në një pikë. Komisari i batalionit ishte përgatitur përf gjithçka. Me mendje ai kishte zhviluar betejën. E dinte ku ndodheshin vijat e kompanive, ku ishin mitralozat e rëndë, ku ishte mortaja 81 mm.

I vrullshëm dhe energjik ngjitte shpatin e malit, rëshqiste e fundosej në borë si gjithë të tje-

rët dhe njëkohësisht bridhte me sytë e mendjes atje lart, në Çukë, pozicion më pozicion.

Qielli borëzonte e dukej si një masë e rëndë dhe e turbullt.

Nga thellësia e asaj turbullire lëvizën dhe u shfaqën disa silueta. Siluetat nisën të afroheshin dhe morën formë. Pararoja!... Shokët e batalionit njohën partizanët e pararojës, që njoftonin komandën e batalionit se përtej Çukës, fare pranë saj ndodhej armiku. Ai ka epërsi të madhe në njerëz, në armatim dhe municion. Kundër tyre, në lindje, lufton çeta teritoriale e fshatrave të luginës dhe komandanti i asaj çete, Halim Haliti, ka mbetur i vrarë nga një predhë mortaje.

Në Jug, te të tri grykat janë përqëndruar forcat e batalionit «Gjergj Kastrioti» që luftojnë me mercenarët e Ballit dhe me një regjiment të motorizuuar. Gjithashtu fshatarë dhe barinj të staneve ishin grumbulluar te Limeri i Hajdutëve dhe prisin urdhër. Bëheshin ndonja njëzet burra, të gjithë të armatosur.

— Sa kohë duhet për të ngjitur Çukën? — pyeti komisari. Sytë e tij ishin përqendruar diku përpara, në një pikë të papercaktuar, mbi kapat e partizanëve të pararojës, ngarkuar me borë.

— Gjysmë ore, — tha komandanti i skuadrës.

— Gjysmë ore... — përsëriti si jehonë komisari i batalionit dhe një krah i mustaqeve i lëvizi me nervozizëm. — Duhet të ngjitemi në një cerek ore!... Para!

Një mjegull e trashë u var me shpejtësi nga jugperëndimi dhe mbuloi luginën. Ngjyra e saj e përhime e bëri më të errët e më të pasigurt atë pasdreke dhjetori me shira.

Ramë Qarri vështronte nga baxhoja e ashefit përmes xhamit të lagur si ikte tutje, drejt verilindjes, ajo mjegull. Vështronte degët e zhveshura e të zeza të dardhës së madhe në oborr, murin e vjetër prej guri të avllisë, rrëzuar e prishur aty-këtu si dhëmbë të rënë.

— Hë? — pyeti tjetri, që e quanin Sefë.

Ramë Qarri e vështroi. Donte ta shih te në sy, si për t'i blerë mendjen, por sytë e tjerit nuk dukeshin për shkak të errësirës që kishte rënë në dhomë. Donte të ndizte kandilin, por u kujtua se s'kishte vajguri.

— Çfarë «hë»? — tha Ramë Qarri.

— Po ja... nuk japid, — tha ai tjetri.

— Do të japid, — tha prerë Ramë Qarri dhe goditi fort me fundin e patericës së tij mbi truallin e gurtë.

Sefa heshti. Thithi cigaren dhe në dritën e saj të pakët Ramë Qarri dalloj hundën me samar të shokut dhe mollëzat e kërcyera.

— S'mud t'i lëmë pa bukë njerëzit tanë. Në s'japid me dëshirë, do t'ua rrëmbejmë! Ne jemi pushtet këtu.

Sefa tundi kokën i menduar. Ajo lëvizje sikur tha «ç'bela!... ç'bela...!»

— T'ua rrëmbejmë... — përsëriti ai fjalën e shokut. — Pastaj ata do ta hapin gojën çorap, do të

shfryjnë e pështyjnë sa t'u nxjerrë gurmazi, jo na vodhi pushteti, jo po këshillat plaçkitin, jo po...

— Mirë, mirë... — e ndërpree Ramë Qarri. — Le të flasin, po ua mbajti. S'i dëgjon njeri sojin e Jasharit e të Feride hanëmit, i njohin.

Sefa përsëri tundi kokën i menduar: «Ç'bela!... Ç'bela!»

— Lëre, lëre... — psherëtiu ai.

— Ja, kështu, prandaj dhe do t'ua marrim...

— E ata gojën do ta hapin, o Ramë, — ngulmoi tjetri.

— Punë pér ta!... Pushteti ka gjyq e gjyqi ka plumb. Me plumb ua vulosim gojën... Oj!

Ajo «oj» ishte si një jehonë e mendimeve që i gëlonin në kokë.

Jashtë binte shi. Dëgjohej vala e tij si përplasej në mure dhe në oborr. Ulërima plot vajtim e erës mbi skelete drurësh e mbi rrafshina bënte të dukej sikur qanin me ulërima qiell e tokë bashkë.

— Shëndre me shira, — tha Ramë Qarri.

— Bela!... Bela!... — tundi përsëri kokën tjetri.

— Atje lart hedh borë, — tha prapë Ramë Qarri. Ai përsëri ngriti dorën në drejtim të maleve.

— Hedh! — tha prerë Sefa. — Hedh!

Një copë herë ata pinë në heshtje duhan·dhe dëgjuan shiun. Mendonin pér kohën. Kohë të vështira!

Ramë Qarri pyeti:

— Bilua kur vjen?

— Ka ardhur me të dyja kafshët, — u përgjigj tjetri.

— Mirë!

Ramë Qarri përsëri ra në mendime.

— Ka ardhur edhe një nga Zallishta, pruri miell dhe ca fishekë... Edhe ata të përtejllumit miell na dërguan, — shpjegoi Sefa. — Fukaraja e shkretë s'kursehet, po s'kanë ç'japin më.

— Mirë.

— Miellin e shpumë në plevicën e merhumit Qazim. Ç'ta bëjmë?

— Bukë të bëhet! — tha prerë Ramë Qarri.

— Mirë!

Pastaj ata heshtën, gjithsekush në mendimet e veta. Po edhe mendimet e tyre të përbashkëta ishin: buka, municioni, veshmbathjet... Sepse i përbashkët ishte edhe shqetësimi i tyre: Ajo luftë e egër e pabarabartë, atje në Çukë.

Nëpër trarët e kalbur gërryente krimbi. Nëpër qeprat minjtë e uritur vraponin dhe ziheshin me njëri-tjetrin.

— Merr Zanon dhe Bilon dhe i shkonit edhe një herë asaj shtrigës... — Ramë Qarri pështyu në vatër dhe pastaj hodhi hi mbi të. Në s'pranoftë me politikë, tundi koburen. Miellin t'ia merrni të gjithë, kështu si them unë! Merrini ca djathtë, ullinj, pastërma, nja dy shtëmba vaj... Hajt, hajt! Merrjani, se të vjedhura i kanë, neve na i kanë marrë. Dhe t'i thoni, kështu t'i thoni Jasharit: kush nuk ndih këshillin, ndih armikun, e kush ndih armikun, ha koqen e plumbit në lule të ballit!... More vesh, Sefë?

— Ia them unë, — tha Sefa. — Ters është me atë bythëmokrrën që tundet e shkundet, pa me Jakupin ashtu llafos edhe unë.

— Ti mos i vështro tulet, por tundi koburen.

— Mirë.

Sefa u ngrit.

— Dëgjo këtu! — e ndali Ramë Qarri. — Jashar dyqanxhiut kërkoji dhe dy teneqe me vajguri.

Sefa hapi derën dhe doli. Pastaj dera u mbyll me krismë. Ramë Qarri mbeti fare i vetëm në dhomë, i vetëm një mendimet e tij.

«Gjithë krahina një merak ka. Po ç'e do, meraku bukë s'bëhet dot...».

Jashtë binte pa pushim një shi i shtruar e i flohtë.

* * *

Porta e rëndë e oborit u hap me tërsëllëm dhe në prag, nën qemerin e saj të gurtë, u duk i mbështjellë me një gunë, i lagur, i lodhur e i tro-maksur Asllan Qenani.

E shoqja e Ramë Qarrit, Haxhireja, e njuhun menjëherë atë që ishte futur në oborr.

«Asllani, — tha, — nipi i mulla Kamberit nga Kumishta. Vetëm hunda i paska mbetur, ditëziut!...»

Zbriti shkallët me një pallto të vjetër hedhur mbi kokë dhe iu afrua. Asllan Qenani rrinte nën qemerin e gurtë të portës gojëkyçur.

Ajo heshtje e trembi gruan.

«Ky ngjan sikur e kanë rrahur», mendoi ajo. Pastaj pyeti:

— C'do të na thuash, o ditëzi?

Asllan Qenanit iu drodh buza si më të qarë.

— Mbaruam... — gulçoi ai. — Na shoi mortaja e huaj...

Në gjoksin e gruas lindi një klithmë, por e përmbajti.

Asllan Qenanin e futën në konak. Akoma nuk ishte ulur kur u dhanë në portë njerëz nga të lagjes.

— Fol! — tha Ramë Qarri.

— C'të them?... Për ne ka folur mortaja! — tha Asllan Qenani.

— Fol! — nguli këmbë i pari dhe e përplasi, sipas zakonit, patericën.

— Të gjithë u vranë, — tha Asllan Qenani. — Të gjithë... Komandantin tonë, të ziu Halim Haliti e griu mortaja, e bëri përslesh, sa s'e njeh e ëma. Të tjerët mbetën plagosur e gjakosur, kushti c'heqin!... Kushedi ku zvarriten grykave e shpellave barkçjerrë, pa një ndihmë, pa një mbrojtje!...

Ramë Qarri kokëvarur, superënë e si i thver inë dvsh mendonte svpërdhe për atë hata që sillte ky nivoi i mullà Kamberit... I ziu Halim Haliti! Kishin llafosur tërë natën, tri ditë më parë. Kishin nirë edhe atë pak raki që mbante për sebepë e shoqja dhe i dukej sikur e njihët nië jetë të tërë... Kur e kishte nörciellë në sabah nër në stanet e vjetra, përtej Çukës, i kishte thënë:

«Të mos isha sakat, nuk rrija pa ardhur me ty atie lart, o Halim!...»

Halim Haliti e kishte përqafuar një copë here të gjatë. «Edhe këtu luftë të madhe ke përra. Po ti nuk je nga ata që i lëshon zemra,

nuk pret duarkryq ti, jo!...». — Kështu kishte thënë e kishte ikur.

«Tani s'qenka më as Todi, ai komisari, që e tirrte fjalën me lezet e hollë-hollë... as të dy çunat e Laze Kaleshit. Goxha djem! Ta kishte qejfi t'i dëgjoje kur flitnin... Eh!...»

Ramë Qarri u përmend.

— Po batalionin partizan? — pyeti.

Fytyra e verdhë e Asllanit u zbeh edhe më.

— Batalioni?!... Ç'batalion?... Unë nuk pashë batalion të vinte përpjetë...

Këtë radhë qe Ramë Qarri ai që po e vështronnte tjetrin me një palë sy prej të çakërdisuri.

— Po nejse. — tha Asllan Qenani. — Edhe në paçin shkuar vërtet, ç'do të bëjnë? Armiku vjen mizë lisi, asgjë s'e ndalon!

Ramë Qarri vështroi me habi të madhe gjithë të pranishmit. Ai vetë i kishte përcjellë gjer përej fshatit. Atje kishte qëndruar një copë herë, derisa ishin zhdukur në errësirë dhe zhurmat e fundit të potkonjve të mushkave të batalionit, të ngarkuara me arka e mitraloza...

— Ç'thotë ky, or vëllezër? Merrni gjë vesh ju?.. Unë nuk e kuptoj ç'gjuhë flet! — tha Rama, që ndiente hutim dhe dhimbje bashkë. A nuk u nis sot me natë batalioni partizan, moj motrani? A nuk mori udhën pér në Çukë pa ngrënë e pa u çlodhur?.. Fjetën apo s'fjetën te ti mbrëmë komisari dhe nënkomandanti me tre të tjerë, moj plaka e Qazimit... E! Ç'thotë ky i nipi i mullait kështu?...

Njerëzit heshtnin. «Ç'është ky kiomet i zi?! Ç'thotë kështu ky Asllan Qenani? Mos është trembur nga dyfeku atje sipër dhe vjen këtu e fut

panik? Po pse s'shkoi drejt e në shtëpinë e tij? Pse e solli lajmin drejt e këtu në shtëpinë e kryetarit?... Qysh është kjo punë, xhanëm?...»

«E, qysh është kjo punë?... — mendonte dhe Ramë Qarri. — Mos bën punën e armikut dhe vjen të futë panik ndër ne?... Të tërë të vriten? Të tërë të mbeten atyre shkërkave? Dhe ky... Ky Asllani na shpëtoka dhe vjen fill i vetëm! Si, xhanëm, kështu? Na shpëtoka ky, që njëdizaj hodhi dyfekun krahëve dhe na u vrakërtan gjithë ata burra që ia kanë marrë dorën luftës me kohë!...»

— Dëgjo, o Asllan Qenani... Më thuaj, ti pse nuk qëndrove të vdisje me shokët?

— Po ja...

— Dua të ma thuash troç, — e ndërpren Ramë Qarri.

— Po ja, njëri duhej të vinte, o Ramë... Duhej të lajmërohej fshati dhe tërë bregu i lumi se po vjen dushmani... I egër, më i egër se tjetër herë! Vret e dieg c'gjen përpara... Të ikim, o Ramë, të fshihemi shpellave!...

«Shpellat... Mos erdhi prapë koha të fshihemi në to? Ato ishin strehë të fshatit. Mali dhe guri kishin hapur barkun e tyre dhe e kishin bërë strehë të njerëzve. Sa herë ishte mbledhur gjatë historisë së tij ky fshat në ato shpella... Dhjetë herë?... Njëzet herë?... Njëqind herë... S'mbahei mend. Askush nuk mund t'i numëronte shpërnguljet e tij! Askush nuk dinte kur ishin strehuar për të parën herë atje, po e dinin që iknin dhe në cdo prag, në cdo ulli, në cdo shkëmb linin burrat, një tytë dyfeku. Nga hatullat e sëndukët kishin dale armët e vjetra: martinat, dogratë, nagantët, së-

pata, kosoret... Armët e vjetra dhe këngët e vjetra!... Atëherë e vranë Agushin e Ago plakut, të nderuar në të gjithë kazanë. E vranë me të vëllanë, më të dalë të fshatit...»

— Ja, prandaj erdha, — foli Asllan Qenani.
Ramë Qarri u drodh.

— Po pse, xhanëm, të vish ti? Ti korrier nuk je, se korrier është Veliu i Çelo Zenjalit, apo si më i shpejtë nga këmbët... ë?!

— Po ja... që të iknit sa më shpejt, — deshi t'i bënte bisht përgjigjes Asllan Qenani.

— Nuk do të lëvizim me llafin tënd, o Asllan. Në u dashtë, do të lëvizim, por ama atëherë kur të vendosë shtabi i batalionit atje sipër dhe këshilli clirimtar këtu poshtë... Po me llafin tënd, jo!

Pastaj kishte zënë të ecte duke trokitur me forcë, mbi plloçat e gurta të oborrit, patericën.

Në shpirt luftonin e kacafyteshin egërsisht dy ndjenja të kundërta: dyshimi i humbjes dhe besimi në fitore.

«As Halim Haliti, as Tod komisari, asnjeri... asnjeri s'ka pësuar gjësendi!... Ky i nipi i mulla Kamberit, ky qen bir qeni, gënjen... Gënjen!»

E më pas thirri sa bubulloi konaku:

— U tremb për vete ky dhe vjen të na trembë edhe ne... Mos i besoni këtij qen bir qeni, ky nuk është partizan!

Nierëzit heshtnin e vështronin Asllan Qenanin. Ai qëndronte kokëvarur, i mjerë e i vëtmuar, në mes të atyre njerëzve që e vështronin me ngulm, me dyshim e mosbesim.

— Edhe në qofshin vrarë, — nisi të fliste për-

sëri Rama, — do të nxjerrim të tjerë. Mos shteroi gjaku dhe burräria e fshatit?

— Jo, o kryetar, akoma s'kanë shteruar!

Para Ramë Qarrit bëri ballë, kokëpërjetë e çehrendritur, Tajari i merhumit Qazim.

— Jep urdhër, o këshilltar! — tha ai.

Ramë Qarri u çel dhe një mallëngjim i thellë e pushtoi. Njerëzit zunë të pëshpëritnin dhe u kthyen nga e veja e merhumit Qazim. Mbajtën frymën. Ç'do të thoshte ajo nënë pér birin e vetëm?

Po në vend të saj foli Tajari:

— Xhixho, — përsëriti ai duke i vajtur pranë.

— Më rrite me mundime pér nder, apo qysh?

— Pér nder e itiball, o biri i xhixhos!

— Bekomë qumështin që më ke dhënë, — tha prerë diali.

— Hallall gjirin... Ti je burrë dhe di ç'bën.

Në heshtje, lotët e nxeh të i rriddhnin si shi në-pérrrudha, i mblidheshin në mjekër e i rrëzo-heshin pikë-pikë mbi truallin e konakut. Diali ia mori kokën midis duarve dhe ia ngriti lart, i fshiu me pëllëmbën e madhe lotët dhe e mbështeti pas gjoksit. Plaka ngjishte fytyrën pas atij kraharoni ende të varritur, sikur të donte të shkrihej njësh me të dhe qante.

— Hait, hajt, mos qai ashtu!... Rrojnë ata atje sivër! E në qofshin vrarë shumë ia, ne do të shkojmë t'u zëmë vendin e të vazhdojmë punën e tvre... Vdekja? Edhe ajo pjesë e jetës është, pse t'i trembesh?... Hesht, s'bën të qash.

Shumë zemra regëtinë në atë konak, shumë zemra dallgëzuan në valët e dhimbjes, hidhërimit, dashurisë, shpresës dhe besimit. Shumë sy ishin

mjegulluar e lagur nga lot të nxeh të nënash, mot-rash, nusesh.

Pasdreke tetëmbëdhjetë djem nga të fshatit Luginas, me këshilltarin Sefë në krye e me pushkë në sup, morën rrugën përpjetë malit, drejt Çukës. Te Gérxhet e Vrimave të Ujkut u takuan edhe me vullnetarë nga të Zhurishtës, Sopit, Baltëzës, Zhukasit dhe, ashtu së bashku, 63 armë u drejtuan andej nga ishte armiku.

3.

Në veri të Çukës, pesëqind metra larg ishte një tjetër çukë, një simotër e saj, por më e ulët. Midis dy majave, në atë gropore të butë, ngrihej një kodër, mbuluar e tëra nga një pyll i dendur dushqesh e bredhash. Mbi degë kishte shtruar bora tri pëllëmbë dhe, ngaqë ishin varur e rënduar shumë, të dukej se do të thyheshin nga çasti në çast.

Pikërisht atëherë, kur nga ai pyll i dendur dolën togat e para të kompanive armike, komandanti i batalionit partizan me kompaninë e parë u hapën zinxhir dhe zunë pozicione në lartësinë e Çukës. Kishin arritur tamam në kohë. Armiku ndodhej nën ta.

Komisari dhe nënkomandanti nxorën dylbitë dhe vështronin çukën tjetër. Në pozicionet e vjetra, të hapura që në luftërat e shkuara; që vendosur artileria armike.

«Armiq të rinj në pozicione të vjetra», mendoi komisari.

Të tjera kompani mbërrinin e me shpejtësi përhapeshin faqes së asaj çuke dhe humbisnin në pyll.

— Tëmën, Mizë lisi, bre! — tha nëpër dhëmbë Elmaz Katanaja duke rregulluar pozicionin me një dy gurë. «Të kishim dobaret fishekë më shumë», mendoi ai.

Dora e tij e madhe kaloi ngadalë mbi gjerdan, duke prekur me gishta një për një, sikur përkëdhelte metalin e ftohtë të tyre. Njëzet e shtatë copë.

«S'janë shumë, por ata që janë nuk do t'i bëj dëm dokudo... nga ata me nishane, rreshter e përpjetë do të gjuaj. Kokës, që t'u vijë mendja vërdallë...»

Kalo Nishani ishte pak më tei, nga e majta. Elmazi ktheu kokën dhe e vështroi një çast. Fytvra e hequr dhe e tendosur i kuitoi atij një susjtë celiku. «Petrit mali», i vuri pikë Elmaz Katanaja.

Xhuzepe Fiorentini dhe Dule Gropa ishin në skacie të zinxhirit, përbri një shkëmbi me damarë të kuas.

— Dasmë do të ngrëmë, më njan, Xhuzepe!... Do lozë deni i kallaixhiut...

Xhuzepe Fiorentini s'mori vesh nga ato që tha Dule Gropa. Ai ishte i zënë me mortajën dhe s'ktheu fare përgjigje.

Dule Gropa vështronte tutje. Një re, si një shtëllunge e rëndë gri, zvarrisej ngadalë, drejt përendimit, duke u çarë e ndarë copë-copë nëpër matat e mprehta të shkrepave. Diku, në çukën tjetër rrahu topi.

Buçima e tij vrapoi një copë herë nëpër qiel, e ndjekur nga jehona që zvarrisej pas, si hije, nëpër lugun midis dy çukave, derisa iku larg e u shua tutje, shpellave e përrrenjeve. Pastaj të shtënati u dendësuan. Buçitjet dhe jehonat u përzien, u ngatërruan dhe ikën tutje, tatëpjetë, si një ortek që shkërmiqej e humbiste nëpër atë shkretëtirë të bardhë bore e guri. Breshri i hekurt i copave të sharapneleve rrëzohej përreth si një epidemi shfarosëse. Predhat shpërthenin diku anash, duke vërvitur në hava copa gurësh e copa akulli. Të tjera fluturonin duke vërvëllyer përmbi kokë si gjarpërinj të çuditshëm fluturues dhe shpërthenin tutje, prapa tyre, në faqen jugore të Çukës.

Të shtënati, buçimat, plasjet, vërvëllimat e jehonat kacafyteshin si shtrigat, në tokë e në qiel. Partizanët heshtnin dhe e lanë armikun të afrohej. Komisari dhe Ukë Ukshini ndiqnin afri-min e tyre. Vështrimi u bridhte majtas, djathtas, poshtë, sikur studionin, matnin, peshonin për të përcaktuar me saktësi atë pikë ku duhej të godit-nin. Artileria heshti. Binte borë. Bora dhe tymi kishin krijuar një mjegull të përhime, që lëvizte me ngathëtësi dhe tretej fjollë-fjollë. Komisari i batalionit nxori nagantin. Ukë Ukshini rrasasi deri në vetulla kapelen e tij prej shajaku. Në vetullën e majtë fillooi t'i rrihte tak-tak, si përherë, ai drejt nervi. Tani armiqtë s'ishin veçse dhjetëra metra larg dhe komisari ua dallonte fytyrat, shenjat në kapatat e gjelbra dhe kryqin e thyer mbi helmetë. «Simbol i thyerjes», mendoi ai.

Armiku po afrohej në formacion luftimi.

Dule Gropa po ndiqte me sy njérin prej tyre. Poshtë helmetës i ndriste si serm fytyra e ngjalur, e rruar taze.

— Bah, çfarë trupi! — u çudit Dule Gropa. — Vetëm e heq parmandën, për ideal!... Kushedi sa tokë do të kish lëruar katrani, atje në vatan të tij!... Hë, katran! Goxha dem, ikën e më bredh përpjetë e tatëpjetë, për turp, me saçin mbi kokë, si samar breshke, ndërsa arat i mbulon ferra... Ptu!... Katran! Po edhe arën time, ama, atë çikë arë, ku m'i griu këmbët stralli, hithra e mbuloi.

Xha Dulja mendoi atë pëllëmbë arë që kishte faqe shullërit, ku prej kohësh s'kishte shkelur këmba e bujkut dhe thundra e Balashit dhe vazhdimisht ndiqte me tytën e pushkës atë katran me fytyrë sermi, i cili vinte serbes-serbes.

— Sikur vete në dasmën e s'ëmës, — shau xha Dulja.

Dikur, përbri tij u dëgjuan tri të shtënët e njo-hura të nagantit dhe një thirrje, që të ndizte gjakun.

— Përpara, partizanë!

Xha Dulja hoqi këmbëzën dhe ai katran bojalli, me fytyrë të kuqe si të nuseve, ra përmbysh.

— Me shëndet! — tha nëpër dhëmbët e rrallë plaku dhe vuri në shenjë një helmetë tjetër.

E goditur nga të tre krahët, kolona armike u trondit, e për një çast e humbi. Po ky që vetëm një çast.

Pastaj hapësira midis pyllit dhe çukës u shndërrua në një vorbull zjarri e shkrumbi. Breshëri mitralozash dhe automatikësh, shpërthime bom-bash, urdhra, thirrje, ulërima...

«Katrahurë, — mendoi Dule Gropa. — S'merr

vesh qeni të zonë!».... Ai merrte shenjë dhe hiqte gishtin. Pa u ngutur, sikur bënte një punë të zakonshme, me lëvizje të kursyera, sikur kryente një rit të mocëm, sa vetë jeta.

Ta-ta-ta-ti!... Ta-ti-ta-ti!...

Diku midis borës që kishte shtruar dhe qiellit të turbullt, diku sipër breshërive dhe krismave, sipër urdhërave dhe komandave, sipër klithmave dhe kujeve, të shkurtër, të qartë, të fuqishëm kumbonin tingujt e borisë. Ata tinguj vraponin bu-bullues nëpër birën e hollë të asaj borie tunxhi, suleshin... dhe nën tingujt e saj sulej mes flakëve të betejës tërë batalioni.

Fytyra e zbehtë e Telo borizanit atë çast kishte marrë një të kuq të lehtë, si prej thëllimit dhe në sytë e tij, që vështronin diku përtej kohës, digjek një flakë e butë, e kaltëreme, për shkak të syve blu. Komandanti i batalionit kishte thënë njëherë, se në betejë ajo borri viente më tepër se një mitraloz i rëndë.

Ta-ti-ta-ti!... Ta-ti-ta-ti!...

Tani luftimet zhvilloheshin kryesisht në një pikë, në atë kodrën e pyllëzuar, që ndodhej midis dy çukave. Kush do ta merrte kodërzën?

Një dyluftim i egër.

Kodërzën e kapën të dyja palët, pra ende nuk ishte kapur nga askush.

* * *

Xhuzepe Fiorentini rregulloi shënjestrën dhe hodhi radhazi tri prëdha.

— Të lumtë! — u entuziazmua Dule Gropa, ndërsa vazhdonte të punonte belxhikun e tij. — Ua bere festet helaq.

Atje pas një dushku qëllonte rrallë e rrallë, me intervale të gjata Elmaz Katanaja. Tani në gjerdanin e tij kishin mbetur edhe shtatë copë fisehekë, ndonëse kishte shtirë me mjaft kursim... Vëtëm gradat, vetëm ata që jepnin urdhra... Dhe s'i kishin shkuar huq... Jo, jo, bereqavers! Arma kishte punuar mirë...

Tani Elmaz Katanaja po priste të afroheshin edhe më. Kush qe komandanti i skuadrës nga ata të njëmbëdhjetë?... Me siguri ai që bën shenjë me dorë... Domosdo ai duhet të jetë! Vërtet s'i duken shenjat, por ai është.

Elmazi mori shenjë dhe qëlloi. Pfu! pështyu.

— Më ngjan se ia ngope krushkës, — thumboi Kalo Nishani, — e hodhe pér hava.

— Djall! — shau Elmaz Katanaja. — Ti do t'më japësh mend?

Ta-ti ta-til... Ta-ti-ta-ti!... Ta...

Tingulli mbeti pezull. Ç'pati?... Kjo pyetje u end si e ngrirë nën qiellin e ftohtë të asaj pas-diteje. Nga këputja e beftë, e panatyrrshme e vijës melodike, komisari ndjeu se diçka e ligë ishte futur midis atyre tingujve, diçka e ftohtë si rryma e vdekjes dhe u rrëqeth. Ç'pati?...

Një plumb shpoi tejpërtej qafën e Telo borizanit. Qafa e tij e hollë, e tretur u mbulua nga gjaku si nga një shall i kuq. Telo borizani fshiu qafën me pëllëmbë është shikoi një çast gjakun e tij, duke mbuluar krahun, afroi pëllëmbën rrëth fytit, duke mbuluar krejt gushën dhe me dy gish-

tërinjtë, të madhin e treguesin, zuri vrimat e plagës.

«Së paku të mbahem deri në fund të betejës. Pastaj... fundja, pastaj asnje punë nuk prish», — mendoi Telo borizani.

Me dorën e djathtë ngriti borinë.

Tingujt e përgjakur, me njëfarë dridhjeje dhe jehone të shkurtër buçitën si një vrundull stuhie mbi tërë fushën e luftimit.

Ta-ti ta-ti!... Ta-ti-ta-ti!... Ta-ti-ta-ti!..

Shokët e batalionit u qetësan, ndërsa komisari i batalionit mendoi se ajo, e liga, ishte akoma midis tingujve, grindej e hahej me ta. Ai e ndiente këtë...

Megjithatë tingujt vraponin të shpejtë si plumbat.

Ta-ti-ta-ti!... Ta-ti-ta-ti!...

...Dhe u ngjirën, u mbytën në gjakun e borizanit, që kalonte bashkë me ajrin në vrimën e ngushtë të borisë.

Ta-ti-ta-ti!... Ta-ti-ta-ti!...

...dhe borizani ra. Si bie ngadalë një fletë limoni, këputur nga era e vrullshme e detit. Ra, sikur po shtrihej të çlodhej nën një qitro a mandarinë. Larg ndiheshin zëra... Ah, zëri i detit! Fjalë e pakuptueshme e grurit dhe rërës së bregut, lindur nga rrënya e butë e valëve të ujërave, që të shtynte të mendoje për madhështinë dhe pafundësinë e jetës...

Komisari i batalionit u zvarrit dhe i shkoi pranë. E ngriti në duar atë trup të brishtë si trup fëmije duke e shtrënguar fort pas gjoksit. Kishte vdekur. Një plumb i dytë e kishte marrë mes për

mes kraharorit Telo borizanin. Akoma nga tyta e borisë që shtrëngonte midis gishtërinjve rridhte pikë-pikë gjak.

— Dritë, — i tha sanitares që ishte zvarritur aty, — na e vranë Telon... këngëtarin fjalëpakë të së ardhmes.

Drita fshiu gjakun nga buzët e të vrarit dhe lotët nga sytë e saj.

* * *

Kalo Nishani s'kishte më asnjë fishek. Rrinte kokëvarur dhe shikonte «Bredën». Arma pa fishekë është një trup pa jetë. Nofullat e tij kockëdale du-keshin edhe më të mprehta për shkak të mjekrës së parruar.

«Po tani? — pyeti veten Kalo Nishani. — Do të bëj sehir si qëllojnë mbi shokët nishanxhinjtë e kryqeve të thyera», — mendoi ai hidhur, dhe pështyu me neveri.

Fare pranë, nga kaçubet e lajthishtes në të majtë qëllonte pa pushim një mitraloz i lehtë armik. «Sikur t'ia rrëmbeja, mendoi Kalo Nishani, — dhe nisi të vështronte vendin përreth. — Sikur t'ia rrëmbeja!...»

Me gjoksin dhe mjekrën pas borës së ngrirë çau dushqet, shpoi përmes ferrave e lajthive, u tërhoq mënjanë, u rrokullis i shpejtë dhe i vë-mendshëm dhe iu afrua mitralierit armik. Qëndroi një hop, sa të mbushej me frymë. Sytë e tij të vegjël e të rrumbullakët, si prej shpendi, ndiqnin

me vëmendje lëvizjet e shpejtuara të ushtarit armik.

«Pa shih, maskarai! — shau nëpër dhëmbë Kalo Nishani. — I bën dëm fishekët...»

Me një kërcim të beftë iu hodh mbi shpinë ushtarit të huaj dhe i nguli, midis shpatullave, thikën.

Kalo Nishani rrëmbeu mitralozin, e vendosi mbi një trung ahu, mori shenjë dhe hoqi këmbëzën. Goditja qe e befasishme dhe nga s'pritej. Kjo bëri që një pjesë e armikut të çorientohej dhe t'ia mbathte në panik.

— Djall! Djall... — u çudit Elmaz Katanaja. — Të ngjeshur që bën, rrufjani!... Bre, të ngjeshur! — e pastaj thirri: — Ulu, more teveqel! Ç'më mbete më këmbë, si hu?

Po Kalo Nishani nuk dëgjonte. Qëllonte. Qëllonte dhe murmuriste nëpër dhëmbë. Në botë nuk ekzistonte asgjë tjeter përveç tèrbimit të tij dhe atyre njollave të errëta, që lëviznin majtas-djathas si gogozhelë të trembur.

Kështu ishte prerë Kalo Nishani: i butë e i qeshur si kënga e laureshës, por ujk i tèrbuar kur e zinte inati.

— Kalo!... Mo-re!... Po, po, po!... Po ulu, ulu, të thonë!

Elmaz Katanaja kishte një copë herë që vërtiste nëpër gishtërinj fishekun e fundit. Vetëm një fishek. Do ta ngul në thelë të majme, — mendoi ai. — Jo, jo, as në tetar e as në rreshter s'do ta humbas. Më lart, më lart, në ata me dekorata...».

Kështu gjykonte Elmaz Katanaja dhe vështronte përtej, nga Kalo Nishani.

Një njollë e zezë u duk atje përtej. Afrohej vjedhurazi. Herë dukej e herë zhdukej. Ndërsa Kalo Nishani s'e kishte mendjen atje.

Elmazi i thirri që të ruhej, po Kaloja ishte verbuar, ishte shurdhuar. Ai merrte shenjë dhe qëllonte me breshëri të shkurtra, kërr-kërr, sikur dërrmonte kockat.

Njolla e zezë zuri pozicion dhe ngriti armën. Por Elmaz Katanaja u ndodhi më i shpejtë. Hoqi këmbëzën dhe ushtari armik ashtu ngriu. E kishte hedhur edhe fishekun e fundit. Kalo Nishani kishte shpëtuar për një qime.

Lufta vazhdonte e kodërza ishte ende e të dyja palëve.

* * *

Armiku përparonte. Ngadalë, i matur, por përparonte.

Armët e batalionit partizan qëllonin rrallë. Gjendja ishte tepër e rëndë. Tërheqja ishte e pamundur. Vetëm ardhja e ndihmave mund ta ndryshonte gjendjen.

Komisari i batalionit vështroi orën, pastaj qafën nga pritej të vinte ndihma.

* * *

Ata mbërriten. Gjashtëdhjetë e tre burra mbërriten në kreshtë të Çukës.

Në krye vinte Sefa, pastaj Tajari i merhumit

Qazim, pastaj tjetri, tjetri, tjetri... plot gjashtë-dhjetë e tre nga fshatrat e Luginës.

Sefa i ndau në Cy pjesë dhe, ndërsa disa morën krahun e djathë, të tjerët morën nga e majta.

Vetë shkoi pranë komisarit të batalionit. Duhej të paraqitej, sigurisht!

Vazhdonte të binte borë, një borë e hollë dhe e ngrirë, si pluhur. Era e merrte me forcë, e ngrinte shtëllunga dhe ua përplaste fytyrës.

Luftha gjëmonte, ulërinte, kërcënohej, cirrej me gjuhët vërvhellyese të predhave, të mortajave, të topave, mitralozave, automatikëve...

Po ata ishin mësuar me gjëmimet e luftës, ashtu si ishin mësuar me tufanet e borës dhe erërat e veriut, sepse, që kur lindën, ato kishin qenë pjesë të pandara të jetës së tyre.

Xhuzepe Fiorentini u mbrojt pas shkëmbit. Tëtë hapa më tutje Dule Gropa rrinte pas një trungu. Një mitraloz i rëndë armik u ishte qepur dhe s'i linte të ngrinin kokë.

«Ah, biri i bushtrës!...»

Xhuzepe Fiorentini i kishte hedhur dy predha me radhë, por pa dobi. Ai qen bir qeni vadhonte t'i rrihte me zjarr të dendur. Xhuzepe i kishin mbetur edhe tri predha. Dhe ai s'dinte ç'të bënte: t'i hidhte edhe ato të tria, apo të priste?...

Atë çast pa që Dule Gropa mori shenjë dhe qëllói. Mitralozi heshti. «Më në fund... — mendoi me një ndjenjë çlirimi Xhuzepe Fiorentini. — Bravo, shoku Dule!»

Ai u var me kujdes në krahun e djathë të

shkëmbit të shihte se ç'ndodhi, por, papritur, diçka e nxehthë, përvëluese i hyri në gjoks, pak më si-për sisës. Xhuzepe Fiorentini u përmbyt mbi të tri predhat e mortajës me duart të shtrënguara në kraharor.

Dule Gropa përsëri mori shenjë. Por një lutzmë grerash të plumbta i vërshëllen në rrëzë të veshit dhe e detyruan të ulte sakakq përsëri kokën mbas trungut.

— Na vrau, a më i hëngsha t'ëmën!... Xhuzepe, terezitja mirë, or i paudhë, hidhja në kokë, bajgës...

Xhuzepe Fiorentini s'u përgjigj e atëherë Dule Gropa u zvarrit deri te shoku. e ktheu në kurriz e i zbërtheu kapotën. Xhuzepe Fiorentini hapi sytë, i hodhi plakut një vështrim të shuar dhe diç deshi të fliste... Po plaku dëgjoi vetëm një rënkim të dobët, sikur dilte nga fundi i dheut.

I tronditur, Dule Gropa tundi një copë herë kokën me thinja. Pastaj foli. I foli vetvetes me dhimbje, me përgjërim, me dashuri:

— Ah, Xhuzepe!... O bir!...

«O bir!...» — Nën kapakët e rëndë të syve italiani pa fyttyrën e largët të nënës së dashur... Atje pranë tezgave, nën diellin e Sicilisë...

Mblodhi ato pak fuqi që i kishin mbetur, i buzëqeshi plakut e me një fije zëri, si një fëshfërimë fletësh në terr shqiptoi fjalët e tij të fundit:

— Continuate... Sono... fe... li... ce!...

Ngriti dorën sikur të donte të kapej diku. Plaku e mbajti në gjoks derisa dha shpirt. Pastaj e uli me ngadalë e me kujdes mbi shtratin e borës.

— Vdiq, — tha plaku, — flori djalë... Gjynah t'i thuash italian!

E s'kishte arrítur t'ia mbyllte sytë, kur një thirrmë e fuqishme u dëgjua:

— Para, partizanë!

Ishte zëri i njojur i komisarit të batalionit. Dule Gropa u hodh përpara. Vraponte... e i dukej sikur opingat i shkelnin nëpër plumbë. Kishte vrapuar kështu një copë udhë, kur dalloi përbri tij fytyra të reja.

«Pa shih, — tha i habitur. — Na paskan ardhur ndihmat!» — dhe thirri sa i hante fytit:

— Me thikë, more, më thikë... Urraaaa!

— Me thikëëë!... — thirri pranë tij një djalë, pothuaj çunak. Ishte Tajari.

Pylli nën Çukë u ndez flakë.

Kishte filluar të errej.

Nga pika trigonometrike e kreshtës, groporja midis dy çukave, kodërza dhe pylli i dendur duke-shin si një arenë zjarresh dhe gjëmimesh.

Armiku, nën goditjen e kësaj vale të re e të freskët, u tërhoq me shpejtësi. Artileria e tyre nisi të rrihte me zjarr majat e grykat. Fushqetat ndrinin dhe, si përmes një mjegulle, nxirrin në pah lartësinë kërcënuese të Çukës, kurrize bre-goresh si gunga, kaçuba dhe hije lëvizëse.

— Uratën paç! — u tall Dule Gropa. — Bëni dritë. t'iu shohim më mirë ku fshihi... —

Ushtarët armiq tani mbaheshin vetëm në pozicionet e vjetra. të hapura që në luftërat e para. Qëllonin me gjithë fuqinë e armëve, por në tym, kuturu...

«Ata janë thyer, — mendoi komisari i batalio-

nit. — Ata e harxhuan tërë fuqinë e tyre... Janë lodhur dhe, sigurisht, kanë filluar të mendojnë për têrheqjen.»

* * *

— Mbi ta!...

Valë-valë, përmes plumbave, vraponin, rrëzo-heshin, gjakoseshin dhe gjithmonë shtyhesin përpara luftëtarët e batalionit partizan e ata të çetës territoriale të Luginasit.

Kohë pas kohe, papritur qelli i zymtë lëkun-dej, hapej si një plagë e kuqe, që pluskonte dritë... Dritë të kuqe, dritë të bardhë, dritë të verdhë, dritë blu...

Ishin raketat e sinjaleve, që përpinqeshin të mblidhnik me gjuhën e tyre ushtrinë pushtuese, të humbur nëpër borë e terr. Nën ato drita bota dukej si një makth: herë e kuqe, herë e bardhë, herë e verdhë, herë blu...

Kur doli në majë të Çukës dhe u hodh në pozicionet e armikut, partizanit Dule Gropa i mba-hej fryma, zemra i rrihte fort dhe djersa, përzier me borë të shkrirë e tym baroti, i qe futur në sy dhe i përcëllonte.

Pas, në gjurmën e opingave të tij, ecte ai djali i ri, pothuaj çunak.

Fare pranë, mbi një mortajë e disa arka ishin shtrirë në pozicione të çuditshme tri kufoma. Dule Gropa kaloi anash dhe bëri më tutje. Pastaj dhe dy të tjera... «Qenkan mbushur pozicionet plot! — u çudit Dule Gropa. — Bre, ç'rupa!...».

Papritur, Dule Gropa qëndroi i goditur nga një mendim: «U thyen!...»

Armiqtë po tërhiqeshin. Tutje, tatëpjetë brinjës, në terrin e zi të natës, dëgjoheshin të shtëna të vetmuara, thirrje dhe ulërima në një gjuhë të pakuptueshme.

«Kështu kanë ikur gjithmonë ata, — mendoi luftëtari plak i batalionit partizan. — Vijnë që matanë detesh e që matanë malesh taborë-taborë, të frikshëm, veshur me zjarr e hekur... dhe pastaj, një natë, ja, si kjo, ikin kope, duke dhënë berihajin në gjuhë të vështira...».

4.

Errësira kishte mbështjellë botën me shaminë e saj të përzitur. Errësirë e thellë, pa një xixë, pa një zjarr, pa një yll në qiell. Nuk dukej këmbë njeriu, nuk dëgjohej zë, as këngë, as vaj. Vetëm qentë lehnin herë-herë me përtim që nga strehët e tyre apo nga mullarët e barit...

Ramë Qarri vente e vinte. Tridhjetë njerëz, të shumtët çunakë dhe pleg, kishin dalë aty lart e kishin zënë pritë. Pritej të vinte nga ajo anë çeta e Osman ballistik. Ai kishte dërguar fjalë se do të vinte në shtëpi atë natë, në saraje. Kurse në oborr trimat e tij do t'i shkonin në hell ata të çlirimtares, me atë të çalin në krye.

Priteshin të vinin dhe nga fshatrat fqinje. Po s'po dukeshin; këto po mendonte kur nga prapa u dëgjua një kollë e thatë dhe turfullimi i një kali.

Drejt tyre, duke hequr një mushkë pér kapistalli, afrohej një njeri.

— Me bukë e ke fjalën, që thua ti, e plumb të rëndë, o Ramë këshilltari. Rrofsh e të rrofshin çunat!... Si m'u ngrysët ju të tjerët?

Ishte Jashar dyqanxhiu. Pér një okë kripë, lëkurën të merrte.

...— Ja, që thua ti, ju prura ca gjëra të vogla, ca gjëra të vogla, ca raki, që thua ti, ca bukë, pastëрма... q'm'u gjend, o Ramë. Sonte të pret kallkani, që thua ti, e thashë të nxeheni ca...

— E, o Jashar, të faltë perëndia ymër, po ne s'të paguajmë dot. Apo do na i shkruash në defter?

Zëri i Ramë Qarrit ishte i hidhur e ironik.

— C'është ajo fjalë pér para? Mua, që thua ti, më deshi zemra e juva solla. Urdhëroni...

— Iu zgjidh quesja këtij!... Ka ngordhur gjëkundi ndonjë gomar... — sekush tha nga ata të çetës.

— Kërkon shtigje, skilja... Ha-ha!...

— Ne, që thua ti, dhe herë të tjera e kemi ndihmuar luftën, ore shokë. — u mbrojt dogëndisur Jashar dyqanxhiu. — Me bukë, me gjellë, që thua ti...

— E de, e dimë! — ia preu Ramë Qarri. — Të tjerët kanë derdhur gjak.

Jashar dyqanxhiu heshti.

— Po këto që na prure na nevojiten, nuk t'i kthejmë, — shtoi Ramë Qarri dhe urdhëroi t'i merrnin thasët.

Jashari i zgjati Ramë Qarrit, por si mënjanë, dy kaushë duhani.

Ramë Qarri i mori kaushët dhe ua dha atyre që ngritën thasët.

— Në toptan, të tëra në toptan, — tha ai.

— Hë, hë... Që thua ti, i drejtë si perëndia je, o Ramë! — u spërdrodh Jashari.

Pas një copë here ai i hipit mushkës dhe po bëhej gati të merrte tatëpjetën nga mesi i fshatit, ku kishte shtëpinë dhe dyqanin, kur Ramë Qarri tha:

— Epo udha mbarë, o Jashar!

Jashari fshikulloi mushkën dhe humbi tatëpjetë nëpër shi e natë.

«E ruan veten, edepsëzi! Duket pret të marrë udhë puna më mirë dhe pastaj të futet drejt e në thela... A, jo, xhanëm?...» — mendonte Ramë Qarri duke tundur kokën e lagur, bërë ujë.

Poshtë, te jazi i mullirit, u dëgjua thirrja e rojës:

— Kush është aty?... Ndal!

Ramë Qarri hodhi dorën në kobure: «Erdhën, jezitët, — mendoi, — na daltë për hair!...»

Njerëzit zunë vend aty ku u kishin thënë.

Ramë Qarri s'fiste. Ai dëgjonte veshëngrehur, mbështetur pas një prallit. Po përgjigje s'po vinte. Dëgjohej vetëm era dhe vala e shiut që goditte tokën.

— Kush është aty?... Do të qëlloj!... — thirri së dyti roja.

— Po ju, c'jeni? — pyeti një zë i trashë.

— Të fshatit jemi, — sqaroi roja. — Mos bëni hap këtej!

— Ne jemi miq, — tha pas pak po ai zë i trashë. — Lajmëro Ramë Qarrin se kemi ardhur ne

të Sopit dhe të Baltëzës dhe ca nga Kumishtja... Unë jam Xhelal Tevliga nga Sopi. Ai më njeh.

Ramë Qarri ndreqi koburen në këllëf. «Xhelal Tevliga është, vetë dora», mendoi ai dhe një valë e ngrohtë ia pushtoi shtatin.

— Lëri, lëri të vijnë lart, o Dane... Janë shokët tanë.

Ata erdhën, të lagur e të bërë ujë. U përqafuan, pyetën për hallet e njëri-tjetrit, këmbyen duhan. Pastaj caktuan vendet, ndreqën pozicionet që të mos i hante plumbi, dyfishuan rojat dhe u futën rrëzë gurëve e drurëve për t'u mbrojtur nga shiu dhe era që të thante.

Duhej të kishte kaluar mesnata, po banda e Osmanit nuk po dukej. As nga ata të malit s'kishte ardhur ndonjë lajm apo urdhër. Kjo ia ngrohte zemrën Ramë Qarrit. «Në rast se s'do të mbaeshin dot në Çukë, partizanët do të tërhiqeshin me shpejtësi në Grykën e Veriut e në të njëjtën kohë do të lajmëronin se ç'duhej të bënim».

5.

Bora zuri të binte qetë, flokë-flokë, si në përrallë. Luftëtarët e batalionit partizan ecnin tatë-pjetë drejt fshatrave buzë lumit, drejt Luginasit. «Aty merr frymë pushteti ynë», mendoi komisari i batalionit.

Binte borë e ata zbrisnin varg njëri pas tjetrit me kokën varur. Armiku qe mundur, por ata ndienin në shpirt t'i shtypte dhimbja për shokët e rënë.

Diku, nga një e çarë midis reve, një tufë rrezesh dielli, si një tufë kallëzish të pjekur, ranë në luginë dhe zbutën për një çast vështrimin e luftëtarëve.

Komisari i batalionit u rrotullua dhe shikoi nga Çuka. Ajo ngrihej e gjithëpushtetshme.

Deri dje ajo ishte një kreshtë si gjithë të tjera. Si çdo kreshtë, edhe ajo kishte emrin e saj: Çuka.

Bora vazhdonte të binte qetë, flokë-flokë. Dule Gropa, mbathur me çizme të reja, shkelte qetësisht mbi borë, sikur shkelte mbi truallin e arës së tij në brinjë. Ekte tatëpjetë dhe mërmëriste në-për buzë vargun e një këngë të padëgjuar deri atëherë:

Lule djemt' e nënave...

Mbas tij, gjithmonë nëpër atë gjurmë që linte ai luftëtar i vjetër, shkonte Tajari i Qazimit.

Elmaz Katanaja vinte pas tyre. Mbi sup i rëndonte «Breda» e Kalo Nishanit. Herë-herë fërkonte hekurin e ftohtë të tytës, sikur të përkëdhelte dorën e shokut të vrarë.

Që atje, në krye të kolonës, komisari i batalionit dëgjoi zërin e ngjirur, por ende të fortë të Elmaz Katanasë. Pas një çasti zërin e tij e mbuloi zëri i fuqishëm i gjithë batalionit:

*Me gjoks çeliku para shkon,
si një rrebesch kudo shpërthen.
armikun ti e shkatërron,
dhe vdekjen i rrëfen.*

PASQYRA E LËNDES

| | |
|-------------------------------------|----|
| Lirikë pranvere | 3 |
| Nëna | 25 |
| Nuk ishte, veç një iluzion | 35 |
| Lule djemtë e nënave (novelë) | 49 |